



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i integruar i studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Drejtësi”

ofruar nga

Universiteti “Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Armela Kromiçi

Prof. Asoc. Dr. Artan Spahiu

Korrik / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË: “DREJTËSI”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program i IntegrUAR i Studimeve të Ciklit të dytë Master i Shkencave në: “Drejtësi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 221, datë 3.7.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	viti akademik 2020 – 2021 7 PAE / 8 PAK; viti akademik 2021 – 2022 12 PAE / 9 PAK; viti akademik 2022 – 2023 8 PAE / 10 PAK; viti akademik 2023 – 2024 8 PAE / 8 PAK; viti akademik 2024 – 2025 8 PAE / 10 PAK;
18	Numri i studentëve:	viti akademik 2020 – 2021 12 studentë; viti akademik 2021 – 2022 13 studentë; viti akademik 2022 – 2023 14 studentë; viti akademik 2023 – 2024 34 studentë; viti akademik 2024 – 2025 40 studentë;

19	Komente / të tjera:	-
----	---------------------	---

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Barleti" është një institucion jo publik, i miratuar me vendimin nr. 571, datë 12.8.2005 për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jo publike "Universiteti "MARIN BARLETI"", në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe është riorganizuar me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, nr. 213, datë 03. 07. 2020. Bordi i Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ka vendosur të akreditojë Universitetin "Barleti" me vendimin nr. 60, datë 16.12.2021 deri më datë 15.12.2026. Universiteti përbëhet nga 4 fakultete:

1. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë;
2. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizimit dhe Sportit;
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative;
4. Fakulteti i Shkencave Mjeksores;

Programi i integruar i studimeve "Master i Shkencave" në "Drejtësi" përfaqëson ciklin e dytë të studimeve universitare dhe ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë, pranë Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Ky program është i licencuar me Urdhër MASR Nr. 221, datë 3.7.2020. Programi ofrohet me kohë të plotë dhe ka një kohëzgjatje prej pesë viteve akademike, duke qenë i ndërtuar mbi bazën e Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) me një total prej 300 kreditesh. Në përfundim të studimeve, studentët përfitojnë diplomën "Master i Shkencave" në "Drejtësi". Ky program është konceptuar dhe zbatuar nga Departamenti i Drejtësisë dhe synon të përgatisë profesionistë të kualifikuar në fushën e drejtësisë, të pajisur me një formim të thelluar teorik, historik dhe doktrinal, si dhe me aftësi të avancuara praktike. Programi i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të një qasjeje kritike dhe analitike ndaj fenomeneve juridike, përmes studimit të legjislacionit vendas dhe të së drejtës krahasuese, me qëllim që studentët të mund të kuptojnë dhe interpretojnë në mënyrë të pavarur problematika të ndryshme ligjore, si në kontekstin kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar. Gjithashtu, programi promovon zhvillimin e aftësive kërkimore dhe akademike përmes përfshirjes në projekte studimore dhe punime shkencore, duke u ofruar studentëve një përgatitje të gjithanshme për të vijuar më tej në karrierën akademike apo për të konkurruar në tregun e punës. Të diplomuarit e këtij programi do të jenë të përgatitur për të mbajtur pozicione të rëndësishme në administratën publike, në sistemin gjyqësor, në profesionet e lira juridike, në organizata vendase dhe ndërkombëtare, si dhe në sektorin privat. Kjo përgatitje shumëdimensionale synon jo vetëm formimin profesional të juristëve, por edhe zhvillimin e një sensi të lartë etik dhe përgjegjshmërie qytetare, në përputhje me nevojat e shoqërisë shqiptare dhe standardet europiane.

Koncept

[Signature]

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Mbështetur në VKM nr. 109/2017 ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupin e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Drejtësi" me anëtarë: **Prof. Asoc. Dr. Armela Kromiçi** dhe **Prof. Asoc. Dr. Artan Spahiu**. Grupi i vlerësimit të jashtëm është trajnuar dhe asistuar nga koordinatori dhe përfaqësuesja e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli. GVJ falë asistencës së përfaqësues së ASCAL iu mundësoi akses online dhe pati mundësi të njëjti fillimisht me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të hartuar nga vetë institucioni në proces akreditimi, që shërbeu si pikënisje për të patur një vizion të qartë të detyrave të këtij grupi pune dhe për zhvillimin e takimeve në institucion në datat 3 dhe 4 Mars 2025. Në këto data, GVJ gjatë vizitës në institucion realizoi një sërë takimesh me Dekanen e Fakultetit të Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, Drejtuesen e Departamentin të Drejtësisë, Koordinatorin e Departamentit, stafin akademik dhe studentët e këtij masteri, NJSBC, zyrën e këshillimit të karrierës, zyrën e burimeve njerëzore, zyrën e marrëdhënieve me jashtë, Erasmus+ dhe të projekteve, sekretarinë mësimore dhe bibliotekën. Gjatë këtyre takimeve GVJ u asistua nga përfaqësuesja e institucionin.

Këto takime u shoqëruan me diskutime dhe në përfundim të tyre GVJ kërkoi dokumentacion shtesë për të plotësuar dhe përditësuar informacionin e përmbajtur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm. Kjo kërkesë u përmbush nga Institucioni dhe dokumentacioni i kërkuar mund të aksesohet online në sistemin e ASCAL. Për realizimin e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve për akreditimin e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Drejtësi", GVJ u mbështet kryesisht në kriteret e përcaktuara tek Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë", në dokumentacionin e përmbajtur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin shtesë dhe në informacionin e përfutur nga takimet e drejtëpërdrejta me grupet e interesit. Të gjithë këta element ndihmuan në hartimin e raportit të mëposhtëm, i cili paraqet vlerësimin e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Universiteti "Barleti", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 08.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 50/23 Prot, datë 08.07.2025. Universiteti "Barleti", më datë 09.07.2025, njofton nëpërmjet sistemit me anë të shkresës me Nr.676 Prot, datë 09.07.2025 "*Kthim përgjigje për draft raportin e vlerësimit të jashtëm*", ku shprehin dakortësinë mbi draft raportin. Në këtë mënyrë draft raporti kthehet në raport final.

Kromiçi

Vlerësimi i Programit të Integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit DVV si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ arrin në gjykimin se programi i integruar i studimeve të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi”, i ofruar nga i Departamenti i Drejtësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë në Universitetin “Barleti”, në të gjithë komponentët e tij, nuk bie ndesh me interesat kombëtare por ka si qëllim përmbushjen e këtyre interesave. Gjithashtu, programi i këtij cikli studimi është në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Barleti” të cilat synojnë të formojë juristë të aftë për të përballuar sfidat e vendit dhe me kompetenca në fushën e së drejtës. Përsëri, programi i këtij cikli studimi është në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në Planin Strategjik 2020-2030 të zhvillimit të këtij insitucioni. <i>Ev. 1.01. Statuti i Universitetit Barleti;</i> <i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i> <i>Ev. 1.03. Plani Strategjik i Zhvillimit 2020-2030;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master i Shkencave në Drejtësi është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimin dhe misionin akademik të universitetit “Barleti”, duke reflektuar fushën e veprimtarisë që mbulon dhe duke promovuar cilësi të lartë në arsimimin juridik. Ky program synon të përgatisë specialistë të kualifikuar në fushën e drejtësisë, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore dhe nevojat aktuale të tregut të punës në Shqipëri dhe më gjerë, duke kontribuar në formimin e juristëve të aftë oër të kontribuar në ndërtimin e një sistemi ligjor efektiv, të drejtë dhe në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Amurci

[Signature]

	<i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i> <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i> <i>Ev 3.08 Programet mësimore (syllabuset)- Pjesa 1;</i> <i>Ev 3.08 Programet mësimore (syllabuset);</i> <i>Ev 3.08 Programet mësimore (syllabuset)- Pjesa 2;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.	Programi i studimit është konceptuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit 2020-2030, Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, duke u përshtatur me fushat dhe drejtimit akademike që ai mbulon. Ky program synon të pajisë studentët jo vetëm me njohuri të thelluara në fushën e drejtësisë, por edhe me një formim të gjithanshëm të karakterit historik dhe filozofik e social, si dhe në aftësitë e komunikimit. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ndihmon në përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar, të aftë për të kontribuar në mënyrë efektive në fushën juridike dhe më gjerë. <i>Ev. 1.01. Statuti i Universitetit Barleti;</i> <i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i> <i>Ev. 1.03. Plani Strategjik i Zhvillimit 2020-2030;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe prirjet globale, mbi bazën e dokumentacionit ligjor vendas dhe ndërkombëtar. Objektivat e tij përfshijnë formimin akademik dhe profesional të studentëve në shkencat juridike, nga njohuritë themelore historiko-filozofike deri te lëndët e specializuara, duke synuar zhvillimin e kapaciteteve analitike, të menduarit kritik dhe aftësive praktike. Programi siguron integrimin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe praktikave profesionale, në bashkëpunim me institucione të sistemit të drejtësisë. Gjithashtu institucioni falë marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe programeve të shkëmbimit Erasmus+ ndikon pozitivisht në përgatitjen për tregun e punës dhe ndërtimin e një profili konkurrues në nivel vendor, rajonal dhe evropian. <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i> <i>Ev. 1.29. Strategjia e Nderkombetarizimit të UNIBA;</i>

Prokuror



	Ev 2. 18 Raport i përfitimeve mbi realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Ev 2. 23.1 Vendim departamenti për njohjen krediteve (ects) studentit nga studimet Erasmus+;			
Konkluzione	Në përfundim GVJ vlerëson se programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" ofruar nga Departamenti i Drejtësisë, pranë Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, Universiteti "Barleti", në të gjithë komponentët e tij, nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të arsimit të lartë në vend dhe nevojave të tregut. Kurrikula e miratuar është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojën e tregut shqiptar për juristë të kualifikuar në fushën e drejtësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Institucioni disponon përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të ofruar dhe menaxhuar programin e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe dokumentacionin përkatës ligjor. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, përmes Departamentit të Drejtësisë, ka në përbërje një trupë akademike të kualifikuar dhe të mjaftueshme për të mbuluar ngarkesën mësimore për vitin akademik 2024–2025. Stafi ka kualifikimin si më poshtë: 1. 3 Prof.Dr; 2. 9 Prof.As; 3. 15 Dr.; 4. 15 MSc; Stafi akademik përmbush kriteret ligjore dhe akademike për fushën e drejtësisë, ka marrë pjesë në programe shkëmbimi dhe

Komisi

[Signature]

	trajnime ndërkombëtare, si dhe ka një numër të konsiderueshëm publikimesh shkencore, të indeksuara në SCOPUS dhe revista të tjera të njohura, të dokumentuara në CV-të përkatëse. Përbërja moshore është e balancuar, duke siguruar transmetimin e përvojës akademike brenda njësisë. Gjithashtu nga vizitat në institucion, GVJ konstatoi se Departamenti ofron ambiente dhe kushte të përshtatshme për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësuar të veprimtarive akademike. <i>Ev 2. 47 Cv Stafit akademik të programit të studimit;</i> <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i> <i>E. 2.55 Tabelë përmbledhëse;</i> <i>Ev. 2.62 Të dhëna tabelore Mjediset e Fakultetit/ Njësive Bazë;</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë i Universitetit Barleti në përbërje të tij ka tre departamente: 1. Departamenti i Drejtësisë; 2. Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës; 3. Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim; Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi” ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe është në përputhje me fushën akademike e të kërkimit të njësisë kryesore. Programi është i klasifikuar me kodin -75MI0421S në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara me Udhëzimin e MAS nr. 31, datë 15.11.2022 “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në RSH. <i>Ev. 2.05 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë;</i> <i>Ev 2. 06 Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Ev 2. 13 Shkresa me kodet e propozuara nga UniBa për kodifikimin e programeve të studimit;</i> <i>Ev 2. 13.1 Korrespondenca me NjZhKC për shpalljen e Kodifikimit të programit;</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”, i ofruar nga Departamenti i Drejtësisë, është plotësisht në

duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për programin. Kjo përputhje dëshmohet si nga përmbajtja e kurrikulës dhe syllabuseve, ashtu edhe nga dokumentacioni mbështetës i dorëzuar (DVV), si dhe nga konstatimet e bëra nga GVJ gjatë takimeve në institucion. Gjithashtu ndërveprimi me departamentet e tjera brenda fakultetit dëshmohet edhe përmes angazhimit të stafit akademik nga fusha të afërta, duke pasuruar përmbajtjen ndërdisiplinare të programit. Ky bashkëpunim ndikon pozitivisht në zhvillimin e një profili profesional më të gjerë për studentët, i cili përputhet me kërkesat aktuale të tregut të punës, që kërkon gjithnjë e më tepër profesionistë me aftësi dhe njohuri ndërdisiplinare. <i>Ev 2. 47 Cv Stafit akademik të programit të studimit;</i> <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i> <i>Ev 2. 06 Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N / A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion me studentët e programit të studimit Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi, GVJ konstatoi se Departamenti i Drejtësisë ka të qartë problematikat e tregut të punës dhe asiston studentët e këtij masteri në përmbushjen e praktikave profesionale pranë institucioneve të ndryshme. Gjithashtu studentët kanë mundësi të përfshihen në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Departamenti me specialisht të fushës, në leksione të hapura apo konferenca të ndryshme studentore. Nga takimi në insitucion GVJ konstatoi se insitucioni falë dhe punës së Zyrës Alumni dhe Karrierës dhe vetë punës së zyrës studentore dhe të këshillimit të karrierës organizon në mënyrë periodike takime dhe me ish student të cilët sjellin eksperiencën e tyre dhe ndihmojnë në orientimin e studentëve në trajtimet e mëtijshme profesionale. Megjithatë, GVJ inkurajon dhe

	rekomandon që Departamenti i Drejtësisë të rrisë pjesëmarrjen e studentëve dhe rritjen e performancën së Klinikës së Ligjit. <i>Ev 2. 08 Studimi i tregut të punës;</i> <i>Ev 2. 19 Paketa e Praktikës;</i> <i>Ev 2. 35 Trajnime aktivitete Departamenti i Drejtësisë;</i> <i>Ev. 1.18. Plani Strategjik 2020-2025, Zyra Alumni dhe Karriera;</i> <i>Ev. 1.27. Rregullore e zyrave studentore dhe keshillimit të karrierës;</i>			
Konkluzione	<i>Në përfundim, GJVJ konstaton se Departamenti i Drejtësisë disponon kapacitetet dhe burimet e nevojshme në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi". Megjithatë, GJVJ rekomandon fuqizimin e mëtejshëm i komponentit praktik, nëpërmjet zgjerimit dhe zbatimit më aktiv të praktikave pranë Klinikës së Ligjit, me qëllim rritjen e përvojës profesionale të studentëve dhe përmirësimin e lidhjes së programit me realitetin juridik dhe nevojat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

riteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së	Institucioni, në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të integruar i studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave në 'Drejtësi'", siguron një marrëdhënie të qëndrueshme dhe funksionale bashkëpunimi ndërmjet njësive dhe personelit përmes ndarjes së qartë të detyrave dhe përgjegjësi, të përcaktuara në Statutin, Rregulloren e Përgjithshme dhe aktet e tjera të brendshme. Sikurse rezultoi dhe nga takimet në Institucion, Njësia bazë, si përgjegjëse për programin, mban rolin kryesor në menaxhimin akademik dhe

përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	organizimin e tij, ndërkohë që bashkëpunon ngushtësisht me strukturat mbështetëse të institucionit si: Zyra e Kërkimit Shkencor, Zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, Zyra në Shërbim të Studentëve, Biblioteka, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Këshillimit të Karrierës (Alumni). Aktet rregullatore përcaktojnë rolin dhe përgjegjësitë përkatëse të drejtuesit të njësisë bazë, koordinatorit të programit dhe personelit akademik të përfshirë në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit. Gjithashtu u konstatua bashkëpunimi i vazhdueshëm përmes shkëmbimit të informacionit të aktorëve të ndrsyhem. Përsëri GVJ konstatori se performanca dhe funksionimi i strukturave vlerësohet në mënyrë të rregullt përmes treguesve të matshëm të realizimit të detyrave dhe raporteve vjetore, duke garantuar monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm institucional. <i>Ev. 1.01. Statuti i Universitetit Barleti;</i> <i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i> <i>Ev 2. 06 Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Ev 2. 07 Raporti Vjetor i Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Ev. 1. 20. Raport vjetor i kërkimit Viti akademik 2023 – 2024;</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, Universiteti Barleti dhe Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda vendit, si dhe me institucione publike, kompani dhe zyra ligjore, pjesë e komunitetit të biznesit dhe tregut të punës. Praktikrat profesionale realizohen në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, si dhe përmes angazhimit individual të studentëve, me mbështetjen e institucionit. GVJ konstaton se ekziston një bazë bashkëpunimesh, <u>por rekomandon intensifikimin e nënshkrimit të marrëveshjeve institucionale, si dhe zbatimin efektiv të tyre, për të rritur ndjeshëm ndërvëprimin me aktorët e sektorit publik dhe privat.</u> Këto bashkëpunime janë thelbësore për zhvillimin profesional të studentëve, rritjen e kompetencave praktike dhe ndërtimin e kontakteve që i ndihmojnë në integrimin në tregun e punës. Gjithashtu, bashkëpunimet ndërinstitutionale ndikojnë

Armando

[Signature]

	pozitivisht edhe në zhvillimin profesional të stafit akademik, përmes shkëmbimeve të përvojës, përditësimit të përmbajtjes mësimore dhe përshtatjes së syllabuseve me nevojat konkrete të tregut. Në këtë kuadër, <u>GVJ rekomandon rritjen e përfshirjes së institucionit në programin Erasmus+, si në drejtim të mobilitetit të studentëve, ashtu edhe në shkëmbimin dhe trajnimin e stafit akademik, me qëllim forcimin e ndërkombëtarizimit dhe përmirësimin cilësor të ofertës akademike.</u> <i>Ev 2. 17 Marrëveshje bashkëpunimi (MoU);</i> <i>Ev. 2.12 Të dhëna tabelore për Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese;</i> <i>Ev 2. 18 Raport i përfitimeve mbi realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i> <i>Ev 2. 23.1 Vendim departamenti për njohjen krediteve (ects) studentit nga studimet Erasmus+;</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Departamenti i Drejtësisë është pjesë e marrëveshje bashkëpunimi si dhe është palë e marrëveshjeve Erasmus+. Gjatë vizitës në institucion, GVJ kostatoi se Departamenti i së Drejtës ka marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e ndihmës juridike falas ky studentët përveç praktikave mësimore mund edhe të trajnohen. Gjithashtu Departamenti i Drejtësisë, zhvillon në mënyrë periodike konferenca shkencore me pjesëmarrjen e studentëve, mentoruar nga pedagogët e këtij departamenti. <u>Gjithashtu rekomandon ngritjen e klinikës së ligjit pranë këtij Departamenti ku në bazë të një procedure të paracaktuar të përzgjidhen studentët që japin kontributin e tyre dhe të rriten profesionalisht.</u> <i>Ev 2. 24 Marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit nënshkruar vitet e fundit;</i> <i>Ev 2.25 Projekte të zbatuara dhe në process Barlet Group në kuader të Erasmus +;</i> <i>Ev 2.25.1 Projekte të zbatuara dhe në process Barlet Group në kuadër të kërkimit shkencor;</i> <i>Ev 2.33 Korrespondencë dhe vlerësim nga DNJF, MD për realizimin e praktikave me studentët;</i>

Rekomandim

[Signature]

Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Drejtësisë vlerëson në mënyrë periodike efektivitetin e marrëveshjeve të bashkëpunimit përmes një komisioni të posaçëm, me fokus në ndikimin që këto bashkëpunime kanë në realizimin e objektivave të programit të studimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe takimet me grupet e interesit gjatë vizitës në institucion, konstatohet se personeli akademik i departamentit dhe studentët e programit të studimit janë përfshirë dhe kanë përfituar nga marrëveshje bashkëpunimi, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, në kuadër të partneriteteve ku Universiteti Barleti është palë. Megjithatë, <i>GVJ rekomandon që të rritet më tej niveli i bashkëpunimit dhe përfshirja praktike e studentëve, në funksion të forcimit të aftësive të tyre për të dhënë zgjidhje bashkëkohore dhe të aplikueshme në praktikë. Ky thellim i përgatitjes praktike duhet të mbështetet në zgjerimin e marrëveshjeve me institucione të specializuara dhe aktorë të tregut të punës, si dhe në integrimin më të plotë të këtyre përvojave në programin e studimit.</i> <i>Ev 2. 18Raport i përfitimeve mbi realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i> <i>Ev 2. 19Paketa e Praktikës;</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Departamenti i Drejtësisë ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione publike dhe private, kompani dhe aktorë të tregut të punës, vendas dhe të huaj, në funksion të realizimit të programit të studimit, aftësimit profesional të studentëve, kërkimit shkencor dhe mobilitetit akademik. Këto bashkëpunime kanë shërbyer si baza për zhvillimin e praktikave profesionale dhe përfshirjen e studentëve në aktivitete jashtëshkollore me karakter formues. Gjithsesi numri i këtyre marrëveshjeve duhet të jetë më i madh.</i> <i>Megjithatë, GVJ rekomandon që Departamenti të rrisë më tej nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të zgjerojë pjesëmarrjen në programin Erasmus+ dhe projekte të ngjashme, si në drejtim të mobilitetit të stafit akademik ashtu edhe të studentëve.</i> <i>Gjithashtu rekomandon ngritjen e klinikës së ligjit pranë këtij Departamenti pasi ndihmon studentët të përfshihen në mënyrë</i>

[Signature]

[Signature]

	<i>aktive në trajtimin e çështjeve konkrete ligjore, nën mbikëqyrjen e stafit akademik dhe profesionistëve të fushës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë 'Master i Shkencave në "Drejtësi"' është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). GJV konstaton se programi i studimit në verifikim përmban të shprehura në mënyrë eksplicite shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj, të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore në fuqi. Programi i studimit është i organizuar për një periudhë prej 5 vitesh dhe zhvillohet me kohë të plotë. Ngarkesa mësimore për çdo vit është 60 ECTS, duke sjellë një total prej 300 ECTS në përfundim të programit. Këto kredite janë të shpërndara në mënyrë të balancuar në 10 semestra. Lëndët në këtë program janë të vlerësuara kryesisht me 4 deri në 6 ECTS; Praktika profesionale zë një peshë prej 12 ECTS; Punimi i diplomës ose diplomimi vlerësohet me 15 ECTS. Konform legjislacionit në fuqi çdo lëndë apo modul ka një kod unik identifikues, i cili mundëson identifikimin e tij. Gjithashtu,

	për secilën lëndë është përcaktuar qartë lloji i veprimtarive mësimore që zhvillohen, si leksione, seminare, punë praktike, etj. Struktura dhe përmbajtja e programit janë të dokumentuara në mënyrë të qartë në planin mësimor përkatës dhe në rregulloren përkatëse. <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i> <i>Ev 3.04 Kuadri i përgjithshëm i veprimtarive formuese të programit;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV-së dhe takimet me drejtuesit dhe pedagogët e programit, GVJ konstaton se programi ofron një formim të plotë në fushat kryesore të së drejtës: civile, publike dhe penale. Lëndët trajtojnë tema të thelluara që kontribuojnë në zhvillimin e njohurive teorike dhe praktike të studentëve. Struktura e programit siguron një larmi specialitetesh dhe mbështet zhvillimin e aftësive për kërkim të pavarur, në përputhje me zhvillimet akademike dhe profesionale. Lëndët janë të ndryshme në secilin vit studimi dhe i pajisin studentët me njohuri të nevojshme dhe të dobishme për ushtrimin në të ardhmen të profesionit të tyre. Programi u jep studentëve kompetenca të dhe i pajis me njohuritë e nevojshme në fushën ndërkombëtare. Programi është ndërtuar mbi parimet e kuptimit kritik të teorive, specializimit profesional dhe përgjigjes ndaj nevojave shoqërore dhe ekonomike përmes lëndëve specifike. <i>Ev 3.08 Programet mësimore Pjesa 1, Pjesa 2 dhe 3;</i> <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit ka të përcaktuara qartë ngarkesat në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse si më poshtë: - Praktika profesionale (kategoria D) zë 4% të totalit të krediteve, ose 12 ECTS; - Detyrimet përmbyllëse (kategoria E) përfaqësojnë 5%, ose 15 ECTS;
	Ngarkesa e çdo lënde llogaritet mbi bazën e orëve në auditor dhe punës individuale të studentit. Nga shqyrtimi i dosjes, GVJ konstaton se stitucioni ka hartuar dhe vënë në dispozicion

Konur

119

	"Paketën e Praktikës" dhe "Paketën e Provës Finale", të cilat përmbajnë udhëzime të qarta mbi zhvillimin e praktikës dhe hartimin e punimit të diplomës. Praktika profesionale organizohet dhe mbikëqyret nga departamenti dhe vlerësohet nga pedagogë udhëheqës. Për temën e diplomës, studentit i caktohet një pedagog udhëheqës dhe puna kërkimore vlerësohet nga një komision i posaçëm në nivelin e njësisë bazë. <i>Ev 2. 19 Paketa e Praktikës;</i> <i>Ev 2. 20 Paketa e Provës finale;</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të	N / A

Korwci

Ally

kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV-së dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se pranimi i studentëve dhe financimi i tyre për ndjekjen e studimeve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet përkatëse nënligjore. Gjithashtu GVJ konstaton se institucioni ndihmon me reduktimin e tarifave dhe me bursa studentet e ekselencës. Megjithatë, <i>GVJ rekomandon që institucioni, pavarësisht se është një universitet privat, të shqyrtojë mundësinë e ofrimit të bursave të studimit edhe për studentët me aftësi ndryshe, në funksion të promovimit të barazisë së aksesit në arsim dhe nxitjes së ekselencës akademike.</i> <i>Ev 2. 71 Kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të pranimit në programin e studimit Praktikë dokumentacion, llojet e bursave;</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga MAS dhe në shqyrtimin e DVV-së, programi i integruar i ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”, i ofruar nga Departamenti i Drejtësisë në UniBa, i përket fushës së gjerë “Biznes, Administrim dhe Juridik” (Fusha 4). Plani i studimit është në përputhje me kriterin ligjor që kërkon përmbajtje të ngjashme në të paktën 70% të strukturës dhe përmbajtjes së tyre; reflektim të të njëjtit nivel kualifikimi dhe strukturë akademike që verifikohet: - Emërtimit të programit; - Nivelit të kualifikimit; - Kohëzgjatjes së programit; - Struktura të lëndëve; - Peshës së lëndëve në planin mësimor; - Karakterit të njësive bazë dhe kryesore; <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës	Programi i mësipërm është shoqëruar me kodin zyrtar: 75MI0421S, i cili është përcaktuar nga MAS në përputhje me

Handwritten signature

Handwritten signature

së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	VKM nr. 310, datë 11.05.2022, dhe Udhëzimin nr. 31, datë 15.11.2022 të MAS për procedurat e kodifikimit.			
	Ev 2. 13.1 Korrespondenca me NjZhKC për shpalljen e Kodifikimit të programit;			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Duke marrë parasysh zhvillimet bashkëkohore në arsimin e lartë dhe procesin në rritje të ndërkombëtarizimit, si dhe duke u mbështetur në marrëveshjet ndërkombëtare dhe projektet bashkëpunuese ku është palë institucioni, GVJ vlerëson se ka potencial real për të avancuar në drejtim të ofrimit të programeve të përbashkëta të studimit. Këto programe, të realizuara në bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë, vendase apo të huaja, do të kontribuonin ndjeshëm në formimin e studentëve, duke i përgatitur ata për të përballuar sfidat e një tregu pune gjithnjë e më global dhe dinamik. <i>GVJ rekomandon që institucioni të ndërmarrë hapa konkretë drejt zhvillimit të këtyre programeve, si një formë e avancuar e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe si një mekanizëm efektiv për rritjen e cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të studimeve.</i> Ev. 1.29. Strategjia e Nderkombetarizimit te UNIBA;			
Konkluzione	Programi i studimit është i organizuar dhe zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor kombëtar në fuqi, si dhe me aktet e brendshme rregullatore të institucionit, duke garantuar përmbushjen e standardeve akademike dhe administrative. <i>GVJ rekomandon që institucioni të intensifikojë përpjekjet drejt ndërkombëtarizimit të programit, përmes nismave konkrete si zhvillimi i programeve të përbashkëta studimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, si vendase ashtu edhe të huaja.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Konkluzioni

[Signature]

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																						
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Drejtësisë është njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë në Universitetin "Barleti", i krijuar me Urdhër nr. 511, datë 24.10.2019 dhe Urdhër nr. 213, datë 3.7.2020 të Ministrisë së Arsimit. Universiteti është i akredituar me Vendim nr. 60, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë ka në përbërjen e tij tre departamente: 1. Departamenti i Drejtësisë; 2. Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës; 3. Departamenti i Qeverisjes, Shkenca Politike dhe Komunikim; Referuar dokumentacionit të kërkuar gjatë vizitës në institucion Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë në tre vite akademike përbëhet nga staf me kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th rowspan="3">Kualifikimi i stafit akademik të</th><th colspan="6">Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë</th></tr><tr><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>2</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>7</td><td>3</td><td>6</td><td>3</td><td>7</td><td>2</td></tr><tr><td>Dr/Phd</td><td>7</td><td>20</td><td>9</td><td>10</td><td>9</td><td>6</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>11</td><td>11</td><td>10</td><td>14</td><td>5</td><td>10</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>26</td><td>35</td><td>26</td><td>27</td><td>22</td><td>20</td></tr></table> Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Drejtësisë. Referuar të dhënave, GVJ konstaton se kjo njësi bazë përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm (PAE) dhe atë me kontratë (PAK). Kualifikimi i stafit të departamentit në tre vite akademike ka është si më poshtë:	Kualifikimi i stafit akademik të	Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë						2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	1	1	1	-	1	2	Prof. Asoc.	7	3	6	3	7	2	Dr/Phd	7	20	9	10	9	6	Msc.	11	11	10	14	5	10	Gjithsej	26	35	26	27	22	20
Kualifikimi i stafit akademik të	Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë																																																						
	2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																		
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																	
Prof. Dr	1	1	1	-	1	2																																																	
Prof. Asoc.	7	3	6	3	7	2																																																	
Dr/Phd	7	20	9	10	9	6																																																	
Msc.	11	11	10	14	5	10																																																	
Gjithsej	26	35	26	27	22	20																																																	

	Kualifikimi i stafit akademik të	Departamenti i Drejtësisë					
		2022-2023		2023-2024		2024-2025	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	-	-	-	-	-	1
	Prof. Asoc.	4	1	3	3	4	1
	Dr/Phd	1	7	1	5	4	4
	Msc.	3	2	4	6	3	8
	Gjithsej	8	10	8	14	11	14
Bazuar në kualifikimin e stafit akademik dhe të cv-ve të tyre përmbushen kriteret e nevojshme të parashikuar në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësisë bazë. <u>Rekomandohet</u> që institucioni të ndërmarrë masa konkrete për mbështetjen e stafit të tij akademik që mund të realizohet përmes ofrimit të mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe për publikime akademike, duke nxitur kështu rritjen cilësore dhe qëndrueshmërinë e trupës akademike. <i>Ev 2. 47 Cv Stafit akademik të programit të studimit;</i> <i>Ev 2. 10 Të dhëna tabelore mbi cilësinë e stafit mësimdhënës për programin e studimit për tre vitet e fundit (Tabelat 6);</i>							
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.		Nga shqyrtimi i dosjes, vizitës në institucion dhe takimit me studentët, GVJ-ja evidentoi se Departamenti i Drejtësisë angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin e procesit mësimor, duke përfshirë edhe stafin ndihmës akademik për të siguruar mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore në tërësi. Sipas rregullores së programit të studimit, përgjegjësi i departamentit ka një rol kyç dhe është përgjegjës për ecurinë e programit dhe ka caktuar një koordinator me detyra të qarta dhe të përcaktuara për përmbushjen e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë kontekst, studentët, përveç pjesëmarrjes në mësimdhënie në auditor, zhvillojnë praktikën profesionale pranë një institucioneve apo organizmave të tjerë nën mbikëqyrjen e					

komitet

[Signature]

	pedagogut përgjegjës të departamentit, i cili vepron si udhëheqës i praktikës. Megjithatë, ashtu siç theksohet edhe më lart në këtë raport vlerësimi, GVJ-ja nënvizon nevojën për të avancuar më tej në drejtim të ngritjes dhe funksionalizimit të Klinikës së Ligjit, si një komponent i rëndësishëm i zhvillimit praktik dhe profesional të studentëve të drejtësisë. <i>Ev 2. 19Paketa e Praktikës;</i> <i>Ev 2. 11Praktike shkresakthim përgjigjje, korrespondenca me institucione të ndryshme për realizimin e praktikave profesionale;</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Sipas Rregullores së Universitetit, një nga anëtarët e stafit akademik të Departamentit të Drejtësisë është emëruar në detyrën e Koordinatorit të programit. Në mënyrë të veçantë, <i>neni 6</i> i Rregullores së Departamentit të Drejtësisë përcakton qartë detyrat dhe kompetencat e koordinatorit, në përputhje me zhvillimin dhe menaxhimin e programit të studimit, si dhe organizimin e praktikave profesionale që janë pjesë përbërëse e ciklit të studimit. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me studentët, GVJ-ja konstatoi se studentët ishin të njohur me rolin dhe funksionet e koordinatorit dhe se ekziston një marrëdhënie bashkëpunimi e vazhdueshme mes tyre. Ky fakt dëshmon për funksionalitetin e kësaj strukture mbështetëse dhe për angazhimin e departamentit në mbarëvajtjen e procesit mësimor e praktik. <i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i> <i>Ev 2. 06 Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i>
Konkluzione	<i>Në përfundim, GVJ-ja vlerëson se Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë dhe Departamenti i Drejtësisë, si njësitë bazë përkatëse përgjegjëse për programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave në "Drejtësi", përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sa i përket organizimit dhe strukturës akademike, numrit të stafëve akademike efektive dhe me kontratë dhe në lidhje me vlerësimin dhe akreditimin.</i>

Booncal

11/6

	<i>Departamenti disponon një staf akademik të kualifikuar dhe me përvojë, i cili kontribuon në mënyrë të qëndrueshme në realizimin e objektivave të programit.</i> <i>Megjithatë, GVJ-ja rekomandon që institucioni ta ketë në prioritet e tij rritjen e stafit akademik të brendshëm akademik si dhe performancën profesionale të tij nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme dhe investimeve në trajnime, konferenca dhe aktivitete kërkimore-shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Dokumentat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor janë të plota. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e Programit të studimit, Rregulloren e Departamentit, Planin strategjik të Universitetit të Barletetit, Planin mësimor, kurrikulën e programit të studimit, syllabuset e lëndeve, etj. <i>Ev. 1.01. Statuti i Universitetit Barleti;</i> <i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i> <i>Ev 2. 06 Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Ev 3.03 Planin mësimor i programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm	GVJ konstaton se në planin mësimor të programit të studimit veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, si më poshtë:

Kouaci

[Signature]

për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme A 15% - 20% (kredite); Lëndët karakterizuese (formim specifik sipas programit): B 45% - 55% (kredite); Lëndët ndërdisiplinore integruese dhe/ose lëndë me zgjedhje: C 12% -15% (kredite); Lëndë plotësuese (gjuhë e huaj, informatikë, praktika): D 6 – 8 % (kredite); Detyrimet përmbyllëse (Teza e Diplomës ose provim përfundimtar): E 3%-5% (kredite); Gjithashtu në program përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk janë më pak se 70% në total, konfirmim vendimit nr. 41 të ndryshuar. Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se në planin mësimor paraqiten të qarta ndarja e orëve në leksion dhe seminar si dhe orët që i dedikohen punës së pavarur të studentëve dhe orët jashtë auditorit. <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion me studentët, GVJ konstaton se programi i studimit ofron informacione të qarta në lidhje me kriteret e përgjithshme të pranimit, të programit mësimor të ofruar dhe asistencën që studentët kanë gjetur pranë zyrave të IAL-së. Gjithashtu në faqën e internetit të Universitetit Barleti ka informacion të të qartë mbi procedurat e transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve sepse kjo të lehtësonte informimin më të mirë të studentëve. https://www.umb.edu.al/procedurate-e-aplikimit.html;
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë	Nga shqyrtimi i programit mësimor dhe syllabuseve rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite në përputhje me VKM 41. Informacioni i përfshirë në syllabuset e lëndëve është i qartë dhe i strukturuar në mënyrë të saktë, duke pasqyruar objektivat,

Bouuci

[Signature]

komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	përmbajtjen, metodologjinë e vlerësimit dhe burimet didaktike të nevojshme për ndjekjen efektive të programit. Megjithatë, vihet re nevoja për një rishikim dhe përditësim të literaturës së rekomanduar, me qëllim pasurimin e saj në përputhje me zhvillimet më të fundit shkencore dhe praktikrat bashkëkohore. <i>Në këtë drejtim, <u>GVJ rekomandon</u> të merret në konsideratë integrimi i vendimeve të fundit të gjykatave, si dhe përfshirja e punimeve shkencore, artikujve dhe prezantimeve në konferenca të realizuara nga vetë pedagogët e programit, duke i dhënë literaturës një karakter më të aplikuar dhe të përshtatur me realitetin akademik dhe profesional.</i> <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion me stafin akademik, GVJ konstaton se Departamenti ndjek një procedurë të qartë në përditësimin dhe miratimin e syllabse në cdo fillim viti akademik duke mbajtur në konsideratë nevojat dhe propozimet e vetë këtij stafi. <i>Ev 2. 30Vendim departamenti për miratiminrishikimin e syllabuseve dhe model syllabusi;</i>			
Konkluzione	<i>Programi i integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”, është i detajuar, informues, i strukturuar dhe i organizuar në përputhje të plotë me parashikimet dhe objektivat formuese të këtij cikli studimi, duke garantuar një bazë të fortë akademike dhe profesionale për studentët.</i> <i>Megjithatë, <u>rekomandohet</u> që të vijojë puna për përditësimin dhe pasurimin e literaturës së lëndëve të ofruara, në mënyrë që të reflektojë zhvillimet më të fundit shkencore dhe praktikrat bashkëkohore në fushat përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Bo moci

[Signature]

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i Integruar i Studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" është i strukturuar në mënyrë të qartë dhe të plotë, duke i ofruar studentit formimin e nevojshëm teorik, shkencor dhe praktik në fushën e jurisprudencës. Ai bazohet në një kurrikulë të detajuar që përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve, dhe është në përputhje me fushën që mbulon. Lëndët e programuara janë të ndara në kategori që garantojnë përgatitje të gjerë dhe specifike: lëndët bazë (A), lëndët karakterizuese (B) dhe ato plotësuese, të cilat zhvillojnë aftësi gjuhësore, informatike, komunikuese dhe profesionale. Përmes këtij strukturimi, studentët fitojnë njohuri të thelluara për të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u aftësuar për analizë krahasimore dhe zbatim praktik të koncepteve ligjore në funksion të përgatitjes së tyre për tregun e punës apo studime të mëtejshme. <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërimit shkencor.	Sipas planit mësimor, Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Drejtësi" realizohet me 300 kredite, me kohë të plotë me kohëzgjatje 5 vite akademike të shpërndarë në 10 semestra. Organizimi i planit mësimor dhe shpërndarja e lëndëve në semestra në mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional dhe shkencor të tyre. <i>Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programin e ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master	Programi i studimit i përket kornizës 7 të KSHK, si program i integruar i studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi". Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e këtij programi. Studimet janë me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), konform Kartës së Bolonjës.

Boum



Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Për të siguruar zhvillimin e mëtijshëm cilësor të programit dhe për ta përafuar atë me standardet më të avancuara ndërkombëtare, GVJ thekson se është e nevojshme që institucioni të intensifikojë bashkëpunimin me institucione të tjera të arsimit të lartë që ofrojnë programe në fushën e drejtësisë. Shkëmbimi i stafit akademik në kuadër të këtyre bashkëpunimeve jo vetëm që do të kontribuojë në rritjen profesionale dhe akademike të pedagogëve, por do të sjellë edhe përvoja të reja dhe qasje bashkëkohore në mësimdhënie. Kjo do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin dhe modernizimin e përmbajtjes së programeve mësimore, duke i bërë ato më tërheqëse dhe më të përshtatshme për sfidat aktuale dhe të ardhshme të profesionit juridik.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se raporti midis përgatitjes teorike dhe asaj praktike është i balancuar dhe i strukturuar në mënyrë të tillë që mbështet arritjen e objektivave formues të programit. Aktivitetet praktike si seminarët, projektet, konferencat dhe workshopet janë tashmë pjesë e një praktike të konsoliduar që ndihmon në përgatitjen e studentëve si specialistë të aftë në fushën e drejtësisë. Në të njëjtën kohë, u evidentua se universiteti ka një strategji të qartë për ndërkombëtarizimin, e cila përfshin bashkëpunime me institucione partnere dhe pjesëmarrje në programe ndërkombëtare si Erasmus+. Megjithatë, <i>GVJ rekomandon që të investohet më tej në rritjen e mobilitetit të studentëve, si një komponent thelbësor për zgjerimin e përvojës së tyre akademike dhe kulturore, përmirësimin e aftësive të tyre ndërdisiplinore dhe gjuhësore, si dhe ndërtimin e një profili më konkurrues në tregun e punës.</i> Përfshirja më e gjerë e studentëve në programe të mobilitetit ndërkombëtar do të përforconte gjithashtu vetë procesin e ndërkombëtarizimit dhe do të sillte përfitime të ndërsjella për institucionin dhe studentët dhe më shumë akses në tregun e punës. <i>Ev 2. 23.1 Vendim departamenti për njohjen krediteve (ects) studentit nga studimet Erasmus+;</i> <i>Ev 2.25 Projekte të zbatuara dhe në process Barlet Group në kuader të Erasmus +;</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve	Titullari i lëndës si dhe koordinatori i program i integruar i studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi"

Komisi



/moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	kanë përgjegjësinë të kontribuojnë dhe të verifikojnë që syllabuset e lëndëve të përmbajnë gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Qëllimi i përditësimit të programeve të lëndëve duhet të jetë përparësi në çdo fillim viti akademik dhe duhet të jetë në përputhje me evoluimin e së drejtës, prioritet dhe strategjinë e zhvillimit të vendit dhe me vetë kërkesat e tregut ku synon të integrohen studentët e diplomuar në këtë program studimi. GVJ konstaton se Departamenti ka një procedurë të qartë në këtë drejtim. Nga ana tjetër nga shqyrtimi i dokumentacionit, <i>GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve të ofruara në këtë program studimi kanë nevojë për përditësim dhe përmirësim të literaturës.</i> Nga takimet në institucion dhe nga frekuentimi i ambienteve të bibliotekës, GVJ konstatoi se Fakulteti investon në blerjen e literaturës së kërkuar nga stafi akademik, kur kjo kërkohet si dhe financon botimet shkencore të vetë stafit akademik. Gjithashtu, <i>GVJ rekomandon që puna dhe kërkimi shkencor i anëtarëve të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë cikël studimi të kenë përparësi publikimet dhe kërkimet që i shërbejnë përmirësimit të kurrikulës dhe të lëndëve që ofrohen.</i> <i>Ev 2. 63 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit;</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ konstaton, se syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" në përgjithësi kanë përmbajtje didaktike, shkencore dhe formuese që garantojnë përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të studentëve. Megjithatë, <i>GVJ rekomandon që lëndët e ofruara të përditësohen çdo vit akademik brenda kornizës ligjore vecanërisht përsa i përket literaturës.</i> <i>Ev 3.03 Plan i mësimor i programit të studimit;</i>

Procedura

	<i>Ev 3.08 Programet mësimore (syllabuset)- Pjesa 1, 2 dhe 3;</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" në tërësinë e tij u ofruan studentëve përgatitjen e nevojshme për të përmbushur pritshmëritë e tregut të punës. Nga dokumentacioni i përmbajtur në dosje dhe nga takimet në instucion GVJ konstatoi që Universiteti ka një praktikë të konsoliduar të bashkëveprimit dhe takimeve periodike me ish studentët Alumni si dhe evidentoi raste të punësimit në Fakultet të ish studentëve të tij.			
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" janë në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, si dhe me rezultatet e të nxënës dhe kompetencat që kërkojnë nga tregu i punës. Departamenti i Drejtësisë dhe institucioni në tërësi garantojnë një formim të qëndrueshëm për studentët.</i> <i>GVJ rekomandon që të tregohet kujdes i vazhdueshëm në rishikimin dhe përditësimin e literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduar në syllabuset e lëndëve, për të pasqyruar zhvillimet më të fundit në fushën juridike.</i> <i>Po ashtu, inkurajohet rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, me qëllim rritjen e mobilitetit të stafit akademik dhe përfshirjen më aktive të studentëve në programe ndërkombëtare si Erasmus+, si një mënyrë efektive për të thelluar përvojën akademike dhe për të nxitur ndërkombëtarizimin e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Drejtësisë është i

Ascal

[Signature]

të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	angazhuar dhe ka vendosur kontakte dhe ura komunikimi me aktorë të ndryshëm si institucione shtetëore dhe organizma privat të biznesit, ofron leksione të hapura me personalitete të së drejtës si dhe ka operativ lidhjet me ish studentët Alumni ku ka hartuar dhe një strategji për të përthithur në mënyrë konkrete nevojat efektive të tregut të punës dhe për ti përkthyer më pas në mundësi punësimi për studentët e tij. Gjithashtu sikurse përmendet dhe më lartë në këtë raport, duke qenë se ky kurs studimi ka pak vite që është hapur, GVJ fton institucionin të rrisë bashkëpunimin me palët e treta. <i>Ev 2. 34Praktikeaktivitetet me studente Alumni ndër vite;</i> <i>Ev 2. 09Plani i aktiviteteve vjetore të veprimtarive të Departamentit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstaton se njësia bazë e programit përfshin në mënyrë aktive studentët dhe strukturat e tyre përfaqësuese, përmes realizimit të anketimeve periodike që synojnë grumbullimin e mendimeve dhe vlerësimeve të tyre mbi procesin mësimor. Gjithashtu, studentët angazhohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në organizimin e aktiviteteve shkencore, ku një rol të veçantë luajnë klubet studentore si hapësira për zhvillim profesional dhe bashkëpunim akademik. Institucioni ka zhvilluar një strategji të qartë për ruajtjen e kontakteve me ish-studentët (alumni), duke i përfshirë ata në aktivitete të ndryshme si burim i vlefshëm eksperience dhe mentorimi. Kontributi i tyre ndihmon në krijimin e urave lidhëse ndërmjet institucionit dhe tregut të punës, duke mundësuar një orientim më të mirë të studentëve. <i>Ev. 1.23. Manuali i Klubeve Studentore 2024-2029;</i> <i>Ev. 1.22. Strategjia e Klubeve Studentore;</i> <i>Ev 2. 34Praktikeaktivitetet me studente Alumni ndër vite;</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në	Referuar RVB-së, departamenti përditëson programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me avokatë, noterë gjyqitarë të cilët jnaë edhe pjesë e stafit akademik. Megjithatë <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti i Drejtësisë të intensifikojë bashkëpunimin dhe konsultimin me aktorë të

Koqinca

N/C

bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<i>ndryshëm institucionalë në vend, veçanërisht me organet e reja të sistemit të drejtësisë dhe institucionet që operojnë në këtë fushë.</i> Një ndërveprim më i ngushtë me këto struktura do të ndihmonte në identifikimin më të saktë të nevojave aktuale të tregut dhe zhvillimeve në praktikën juridike, duke shërbyer si bazë për rishikimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve. Kjo qasje do të sigurojë që përmbajtja e programeve mësimore të mbetet relevante, bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesat e profesionit dhe sistemit të drejtësisë në zhvillim.			
Konkluzione	<i>Fakulteti dhe Departamenti përfshin studentët, partnerët, rrjetet dhe organizmat e tjerë në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit, duke synuar realizimin e tij në përputhje me objektivat formues dhe kërkesat e tregut të punës. Megjithatë, <u>GVJ rekomandon</u> që të intensifikohet bashkëpunimi me institucionet e sistemit të drejtësisë, me qëllim identifikimin më të mirë të nevojave aktuale të tyre dhe reflektimin e këtyre nevojave në përmbajtjen e programit.</i> <i>Po ashtu, theksohet nevoja për një proces të vazhdueshëm të rishikimit dhe përditësimit të syllabuseve, duke përfshirë tema aktuale dhe sfida bashkëkohore në fushën e së drejtës, si dhe përfshirjen e literaturës më të fundit dhe relevante në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto masa do të rrisin cilësinë dhe përputhshmërinë e programit me zhvillimet dinamike të vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në	Universiteti Barleti ka objektiva të qarta në fushën e kërkimit shkencor, të cilat reflektohen edhe në rregulloret dhe programin e studimit të Departamentit të Drejtësisë që ofron programin e studimit në shqyrtim. Nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstaton se Departamenti nxit dhe orienton vazhdimisht studentët drejt zhvillimit të aftësive kërkimore, përmes

banoci

[Signature]

përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	përfshirjes së tyre në detyra kursi, përdorimin e literaturës shkencore dhe përgatitjen e punimit të diplomës nën mbikëqyrjen e pedagogëve. Stafi akademik raporton rregullisht mbi aktivitetin kërkimor vjetor, në përputhje me objektivat e studimit dhe të institucionit. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë bashkërendon mësimdhënien dhe veprimtarinë kërkimore duke respektuar lirinë akademike dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen në konferenca e aktivitete shkencore, si dhe organizimin e eventeve me të ftuar nga fusha të ndryshme në mbështetje të programeve të studimit. <i>Ev. 1.01. Statuti i Universitetit Barleti;</i> <i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i> <i>Ev 2. 06 Rregullore e Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Ev 2. 07 Raporti Vjetor i Departamentit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Institucioni mbështet financiarisht Departamentin e Drejtësisë në zhvillimin e kërkimit shkencor, përfshirë infrastrukturën, bazën materiale dhe promovimet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore në kuadër të programit të studimit. Autoriteti përgjegjës dhe koordinatori i programit janë të angazhuar në shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe organizimin e veprimtarive shkencore e kërkimore, duke garantuar mbulimin e aktiviteteve nga stafi akademik. Përsëri, njësia kryesore realizon analiza periodike për verifikimin e punës mësimore dhe shkencore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV dhe takimet me stafin akademik, GVJ konstaton se institucioni respekton lirinë akademike dhe nxit zhvillimin shkencor dhe profesional të personelit, duke financuar projektet dhe botimet e tyre. Megjithatë <u>GVJ rekomandon nevojën për të rritur bashkëpunimet ndër-institucionale brenda dhe jashtë vendit me qëllim rritjen e projekteve shkencore dhe botimet e stafit akademik të këtij universiteti.</u> <i>Ev 2. 09 Plani i aktiviteteve vjetore të veprimtarive të Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Ev 2. 35 Trajnime aktivitete Departamenti i Drejtësisë;</i>

Bo mwx

[Signature]

	<i>Ev 2. 18Raport i përfitimeve mbi realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Institucioni mbështet financiarisht dhe me anë të infrastrukturën bashkëkohore realizimin e aktiviteteve studimore dhe rekreative të studentëve. Gjithashtu, ai garanton bashkëpunimin me institucione simotra për realizimin e mobilitetit të studentëve është pjesë e Programit Erasmus+ për shkëmbimin e tyre. Në këtë drejtim vlen të përmendet projekti për ofrimin e ndihmës juridike falas për qytetarët në nevojë. Nga takimet në institucion me studentët, GVJ konstaton se studentët nxiten dhe motivohen të marrin pjesë në aktivitete shkencore të përbashkëta me stafin akademik si organizimi i konferencave shkencore, etj. <i>Ev 2. 18Raport i përfitimeve mbi realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i> <i>Ev 2. 37Raporti mbi zbatimin e projektit dhe studimit mbi perceptimin e qytetarëve lidhur me ndikimin e Ligjit për Ndihmën Juridike Falas në Shqipëri;</i> <i>Ev 2. 38Konkursi rajonal i FD nga studentët e programit të integruar të studimeve MSH në Drejtësi;</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Universiteti Barleti garanton bashkëpunimin me institucione simotra për realizimin e mobilitetit të stafit akademik dhe të studentëve dhe është pjesë e Programit Erasmus+ për shkëmbimin e tyre. Gjithashtu, nga takimet në institucion me stafin dhe me studentët u evidentua mbështetja financiare në funksion të aktivitete shkencore.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton orientim të qartë në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, duke krijuar hapësira për zhvillimin akademik të studentëve dhe stafit.</i> <i>Universiteti mbështet Departamentin e Drejtësisë si financiarisht ashtu edhe logjistikisht, në funksion të realizimit të detyrave të tij kërkimore dhe akademike, duke kontribuar kështu në përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Arbana

[Signature]

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Drejtësisë dhe koordinatori i programit janë përgjegjës për ndjekjen e procesit mësimor dhe organizimin e veprimtarive shkencore sipas planifikimit vjetor. Departamenti zhvillon leksione të hapura dhe aktivitete që inkurajojnë mendimin kritik dhe angazhimin e stafit dhe studentëve në kërkimin shkencor, si dhe bashkëpunime me institucione të tjera për konferenca dhe projekte të përbashkëta. Një rol kyç ka edhe Koordinatori për Kërkim dhe Inovacion, i cili bashkërendon aktivitetet ndërmjet departamenteve dhe strukturave kërkimore. Institucioni mbështet financiarisht grupet kërkimore dhe ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi për të forcuar veprimtarinë shkencore. GVJ konstatoi përfshirjen aktive të stafit në botime dhe konferenca, si dhe nxitjen e studentëve për pjesëmarrje në to. <i>Ev 2. 36Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit;</i> <i>Ev 2. 09Plani i aktiviteteve vjetore të veprimtarive të Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Ev 2. 35Trajnimeaktivitete Departamenti i Drejtësisë;</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse angazhon në mënyrë të vazhdueshme personelin akademik dhe studentët në projekte të ndryshme, si konferenca shkencore, studime studimore, leksione të hapura me personalitete të njohura të fushës të së drejtës apo përftime nga mobiliteti Erasmus+. Gjithashtu, GVJ konstatoi që Departamenti është i angazhuar dhe në gjetjen dhe ofrimin e praktikave mësimore të stundtëve dhe funksionimin e Klinikës së Ligjit;

Kumari

[Signature]

	<i>Ev 2. 37Raporti mbi zbatimin e projektit dhe studimit mbi perceptimin e qytetarëve lidhur me ndikimin e Ligjit për Ndihmën Juridike Falas në Shqipëri;</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", njësia përgjegjëse harton një plan veprimtarie vjetore, i cili përfshin organizimin e konferencave, leksioneve të hapura, seminareve, workshopeve dhe aktiviteteve të tjera akademike që lidhen ngushtë me fushën e studimit. Këto veprimtari synojnë të krijojnë hapësira të dobishme për përfshirjen aktive të studentëve dhe stafit akademik në diskutime shkencore, përmirësimin e njohurive, si dhe zhvillimin e kompetencave kërkimore dhe profesionale. Departamenti luan një rol parësor në koordinimin dhe mbështetjen e këtyre aktiviteteve, duke vendosur një fokus të veçantë te puna kërkimore-shkencore dhe përfshirja në projekte të mundshme në bashkëpunim me institucione të tjera. Nëpërmjet këtyre nismave, synohet jo vetëm përmbushja e objektivave të programit, por edhe krijimi i një mjedisi akademik dinamik që nxit mendimin kritik, inovacionin dhe ndërlidhjen me praktikatat më të mira në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Ev 2. 09Plani i aktiviteteve vjetore të veprimtarive të Departamentit të Drejtësisë;</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i integruar i ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" është hartuar konform akteve nënligjore dhe strategjisë kombëtare të arsimit. Programi i tij është organizuar sipas Kartës së Bolonjës, dhe synon të përgjigjet nevojave të tregut për të formuar profesionistë të aftë dhe konkurrues në tregun e punës. Nga takimet në institucion GVI konstatoi përfshirjen aktive të stafit akademik në mbështetjen e studentëve, jo vetëm në aspektin teorik, por edhe përmes angazhimit në aktivitete praktike dhe konkurrence. Në këtë kontekst në vëmendje të GVI-së u soll konkursi rajonal mes Fakulteteve të Drejtësisë ku morën pjesë student të vitit të katërt të këtij programi studimi dhe u renditën në vendin e tretë, duke dëshmuar aftësitë e tyre dhe përgatitjen për t'u bërë ekspertë të denjë në fushën e drejtësisë.

Konur

[Signature]

	Ev 2. 38Konkursi rajonal i FD nga studentët e programit të integruar të studimeve MSH në Drejtësi;
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se Programi i integruar i ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" është konform akteve ligjore në fuqi. Ndërkohë, GVJ konstatoi që Departamenti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm në vend dhe rekomandon që këto marrëveshje të jenë efektive dhe të zbatohen në interes të stafit akademik dhe të studentëve të tij. Gjithashtu <u>GVJ rekomandon</u> rritjen e bashkëpunimit edhe me organet e reja të drejtësisë që lindën si pasojë e reformës në Drejtësi por dhe me institucione të tjera të rëndësishme që operojnë në fushën e së drejtës dhe që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë jo vetëm në zhvillimin e praktikave mësimore për studentët dhe mundësinë për punësimin e tyre të ardhshëm por edhe për të evidentimin e nevojave të këtyre institucione. Urdhër nr. 511, datë 24.10.2019 Urdhër nr. 221, dt. 3.7.2020 Vendimi nr. 60, datë 16.12.2021
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i integruar i ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ngarkesa mësimore për çdo vit është 60 ECTS, duke sjellë një total prej 300 ECTS në përfundim të programit. Këto kredite janë të shpërndara në mënyrë të balancuar në 10 semestra. Lëndët në këtë program janë të vlerësuara kryesisht me 4 deri në 6 ECTS Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë; VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr.879, date 18.12.2019; Ev 3.03 Plani mësimor i programit të studimit;
Konkluzione	Programi i studimit garanton një formim të thelluar akademik, promovon ndërkombëtarizimin dhe mbështet zhvillimin e

Konkusi

[Signature]

	<i>kërkimit shkencor, duke krijuar një mjedis dinamik për zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit.</i> <i>Megjithatë, GVJ rekomandon intensifikimin e bashkëpunimit me institucione brenda dhe jashtë vendit, me qëllim organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore që do të kontribuonin në rritjen e cilësisë dhe përmirësisimit të programit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikën profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Baza e realizimit të procesit mësimor në auditor është ora mësimore. Ndër format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit, projektet dhe praktika mësimore. GVJ gjatë takimit me studentët konstatoi se format klasike të mësimdhënies ndërthuren me metoda të ndryshme bashkëkohore dhe Departmaneti në mënyrë të vazhdueshme organizohet dhe leksionet të hapura me ekspertë të fushës. Gjithashtu, GVJ nga diskutimi me stafin akademik dhe me studentët e programit, u informua për mënyrën e zhvillimit të lëndëve të ndryshme dhe në mënyrë të veçantë për peshën e elementëve formues të parashikuar në secilën lëndë si dhe trajtimin në praktikë të vendimeve gjyqësore të dhëna nga

Bocush

[Signature]

	gjykatat shqiptare dhe trajtimin e jurisprudencës së huaj. Gjithashtu, nga takimi me studentët, GVJ u informua se edhe forma e të punës në grup për realizimin e një detyre apo projekti, duke përfshirë zhvillimin e elementëve të tillë si administrimi dhe ndarja e punës ndërmjet studentëve, referimi i materialit përfundimtar nga grupi, etj. Nga shqyrtimi i dosjes dhe nga takimet në institucion GVJ konstatoi se institucioni kishte miratuar një udhëzues të qartë mbi modalitetet dhe metodat inovative të mësimdhënies. Institucioni kishte një sistem funksionat të menaxhimit të të dhënave të studentëve (Sis classter), dhe si stafi akademik por dhe studentët kishin mundësinë e shkëmbimit të informacionit nëpërmjet përdorimit të e-mail zyrtar. <i>Ev. 1.25. Udhëzues për metodat e ndryshme dhe inovative të mesimdhënies;</i> <i>Ev. 1.26. Udhëzues për përdorimin e Struktura të TIK;</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	GVJ konstatoi se personeli akademik ka qenë në vazhdimësi i disponueshëm për zhvillimin e konsultimeve për çështje specifike si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve e shqetësimeve individuale të studentëve në lidhje me procesin mësimor. Gjithashtu, nga ana e personelit akademik, mundësohet komunikimi me studentët jo vetëm gjatë realizimit të procesit mësimor në auditor, por edhe jashtë auditorit nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike (e-mail, rrjete sociale, kontakte në zyrat e karrierës, këshilli studentor etj.) por edhe me përdorimin e rrjeteve sociale si një mjet lehtësues në komunikimin e stafit akademik me studentët si dhe për aksesin në materialet e trajtuara gjatë leksioneve dhe seminareve në platforma si Google classroom e të ngjashme.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Në bazë të dokumentacionit të DVV-së dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka ndërmarrë masa për zhvillimin e kompetencave didaktike të stafit, përmes mbështetjes së kërkimit shkencor, përmirësimit të infrastrukturës mësimore, mundësive për mobilitet ndërkombëtar dhe pjesëmarrjes në trajnime profesionale. Në këtë kuadër, <u>GVJ rekomandon</u> mbështetjen e vazhdueshme financiare për stafin akademik, për të garantuar realizimin

As UUCI'

AKG

	efektiv të këtyre detyrave dhe për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. <i>Ev 2. 22Praktikë dokumentacion mobiliteti i stafit akademik (teaching mobility);</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga shqyrtimi i cv të stafit akademik, GVJ konstatoi se fushat e kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhen me lëndët që mbulojnë dhe se kanë shkallën e kërkuar të kualifikimit për të mbuluar zhvillimin cilësor të mësimin në Programi i integruar i ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi". Gjithashtu nga takimi i zhvilluar me studentët, rezulton se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve teorike shkencore dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit dhe nxit mendimin kritik, punën e pavarur të tyre dhe se ekziston një marrëdhënie respekti të ndërsjellë ndërmjet studentëve dhe stafit akademik të këtij masteri. <i>Ev 2. 47 Cv Stafit akademik të programit të studimit:</i> <i>Ev 3.08 Programet mësimore Pjesa 1, Pjesa 2 dhe 3;</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik i angazhuar në programin e integruar të ciklit të dytë 'Master i Shkencave' në 'Drejtësi', nëpërmjet një procedure të standardizuar dhe të paracaktuar, e cila garanton trajtim të barabartë dhe pa diskriminim. GVJ evidenton gjithashtu përfshirjen aktive të studentëve në vlerësimin periodik të proceseve mësimore dhe të vlerësimit të dijes, përmes administrimit të pyetësorëve standardë. Këta pyetësorë synojnë të mbledhin opinionin e studentëve mbi elementë të tillë si struktura e lëndëve, cilësia e mësimdhënies, procesi i vlerësimit dhe performanca e stafit akademik. <i>Ev. 1.28. Pyetësori i studenteve;</i>

Kouwey

[Signature]

	Ev. 1.06. Raport Vjetori Monitorimit dhe sigurimit te cilesise VA 2023-2024;			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ u informua se institucioni ka ngritur struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe të Cilësisë bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me organet drejtuese dhe njësitë bazë për të vlerësuar në mënyrë periodike efektivitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore. Procesi i vlerësimit mbështetet në procedura standarde dhe analiza të të dhënave të mbledhura përmes regjistrave institucionale, sondazheve, pyetësorëve dhe intervistave me aktorët kryesorë. Strukturat përkatëse luajnë një rol aktiv edhe në nxitjen e metodave inovative të mësimdhënies dhe në trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Ev. 1.06. Raport Vjetori Monitorimit dhe sigurimit te cilesise VA 2023-2024; Ev. 1.05. Strategjia e Nj Zh K C 2024-2029; Ev. 1.07. Rregullore e NJ ZH K C; Ev. 1.08. Rregullore e Komisionit te Sigurimit te Cilesise; Ev. 1.09. Politikat e Garantimit te Standarteve te Cilesise;			
Konkluzione	Institucioni i arsimit të lartë siguron një proces të të nxënit dhe zhvillimi profesional dhe shkencor të studentëve, duke aplikuar metoda dhe praktika të mira që kontribuojnë në arritjen e rezultateve të dëshiruara. Megjithatë, për të garantuar cilësinë e mësimdhënies dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës akademike, GVJ-ja rekomandon se është e domosdoshme të realizohet një investim financiar i qëndrueshëm në rritjen profesionale të stafit akademik, përmes trajnimeve të avancuara dhe mbështetjes për përdorimin e metodave innovative.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

39

Kromiqi

ALG

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në <i>nenet 17 dhe 18 të Rregullores së programit të integruar të ciklit të dytë 'Master i Shkencave' në 'Drejtësi'</i>, dhe në syllabuset e lëndëve që detajojnë mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive në çdo lëndë. Gjithashtu GVJ konstatoi se syllabuset e këtij programi ruanin kryesisht të njëjtën ndarje si më poshtë: - 10 % pjesmarrje aktive në seminare; - 20 % provimi i ndërmjetëm; - 10-20 % ese, detyre kursi; - 50-60 % provimi perfundimtar; <u>GVJ rekomandon</u> që kriteret dhe mënyrat e testimit dhe të vlerësimit të dijeve dhe të aftësive profesionale të publikohen shkrutimit edhe në një dritare lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të intertentit të Universitetit Barleti. <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Ev 3.08 Programet mësimore Pjesa 1, Pjesa 2 dhe 3;</i> <i>Ev 2. 50 Format e kontrollit të njohurive (Tabela 15);</i> <i>Ev 2. 57 Udhëzues didaktik i programit;</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimet e realizuara me studentët, GVJ konstatoi se modalitetet e testimit dhe vlerësimit të njohurive bëhen të njohura për studentët që në javën e parë të çdo semestri akademik, nga stafi akademik. Studentët informohen për metodologjinë e testimit dhe elementët kyç të çdo lënde nga titullarët ose pedagogët e lëndëve. Gjithashtu, u vërejt se koordinatori i programit të studimit luan një rol të rëndësishëm në këtë proces. Informacioni i nevojshëm për studentët është gjithashtu i disponueshëm në syllabuset e lëndëve, ku, në përputhje me natyrën e secilës lëndë, çdo pedagog përcakton pesha e secilit element të vlerësimit perfundimtar, duke e bërë të ditur këtë informacion për studentët.

	<i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Ev 3.08 Programet mësimore Pjesa 1, Pjesa 2 dhe 3;</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme, përfshirë testim me shkrim, me gojë dhe në forma të kombinuara. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentëve mbështetet në frekuentimin e lëndëve (shih nenet 7 dhe 8 të Rregullores së programit të studimit) dhe në parimin e kontrollit të vazhdueshëm përmes detyrave kursi, projekteve dhe postera (shih nenet 17 dhe 18). Nota përfundimtare caktohet sipas këtij kriteri: - nota 4 për 0-49 pikë; - nota 5 për 50-55 pikë; - nota 6 për 56-60 pikë; - dhe kështu me radhë deri tek nota 10 që është për >96 pikë; Po ashtu, në sistemin ECTS, notat konvertohen nga shkronja E deri tek A, sipas përkatësisë. Në takimin e GVJ me studentët, u konfirmua se përdorimi i këtyre formave të vlerësimit ofron mundësinë që të gjithë studentët të shprehin aftësitë dhe talentet e tyre të veçanta, duke mbrojtur kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor. Sipas studentëve, format e testimit ishin të përshtatshme për vlerësimin e përgatitjes dhe kompetencave të fituara në lëndët e programit të integruar të ciklit të dytë 'Master i Shkencave' në 'Drejtësi'." <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i>			
Konkluzione	<i>Në përfundim, GVJ-ja konstaton se institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme dhe standarde për testimin dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale e shkencore, të cilat garantojnë se zbatohen në përputhje me rregullat e përcaktuara dhe janë të njohura për student.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Konkluzi

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimet në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit, sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë gjithë semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare, detyrave të kursit etj, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike: - Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në progralin e lëndës rreth 40-50%; - provimi përfundimtar në rreth 50-60%; Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit; Ev 3.08 Programet mësimore Pjesa 1, Pjesa 2 dhe 3;
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se testimi dhe vlerësimi në programit të integruar të ciklit të dytë 'Master i Shkencave' në 'Drejtësi' realizohet kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale (me shkrim, vlerësimin me gojë dhe i kombinuar) me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve) në platformën google classroom apo google form. Gjithashtu, GVJ konstatoi se udhëzuesi për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit përmban informacione të qarta dhe të thjeshta mbi mënyrën e përdorimit të sistemeve elektronike. Konfrom rregullores së programit, Institucioni ofron sistemin (Sis classter) të menaxhimit të të dhënave të studentëve që ndikon në rritjen e transparencën dhe shmangin format e ndryshme të abuzimit; Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se vlerësimi përfundim i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin, bazën ligjore në fuqi dhe udhëzimet e nxjerra nga vetë Institucioni për këtë qëllim.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se, vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e Departamentit të

Konvic

[Signature]

i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Drejtësisë dhe atë specifike të të integruar të ciklit të dytë 'Master i Shkencave' në 'Drejtësi'. GVJ nga takimi me studentët konstatoi se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente/feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve, provimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Gjatë takimit të GVJ me stafin akademik dhe studentët, u konstatua se Departamenti tregon angazhim dhe kujdes të veçantë në zbatimin e Kodit të Etikës, duke ndjekur me përpikmëri rregullat dhe procedurat për të parandaluar çdo formë plagjiature apo kopjimi, si në provime ashtu edhe në detyrat e kursit. Këto masa janë të bazuara në Kodin e Etikës së institucionit dhe janë të reflektuara në syllabus-et përkatëse të lëndëve. Studentët informohen në mënyrë të qartë lidhur me rregullat e provimeve dhe janë të detyruar t'i respektojnë ato. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstatoi se në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë masat ndëshkimore në rast të shkeljeve të rregullave gjatë provimeve, si dhe udhëzimet për mënyrën e mbikëqyrjes dhe trajtimin e rasteve të plagjiaturës, në përputhje me standardet institucionale dhe akademike. <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Ev. 1.10. Kodi i Etikës;</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas nenit 17 të Rregullores së programit të studimit të integruar të ciklit të dytë 'Master i Shkencave' në 'Drejtësi' GVJ konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash dhe të konvertieshëm nga shkronja E deri A të sistemit europian ECTS. Nota më e ulët kaluese është 5 e cila arrihet me realizimin 50-55 pikë. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve në mënyrë individuale nga pedagogët e lëndës dhe sipas nenit 20 të Rregullores së programit të studimit nga sekretaria mësimore. Në rastin e provimeve me shkrim,

Konur

[Signature]

	studentët kanë të drejtë të kërkojnë rishikimin e tezës dhe të vlerësimit dhe vetëm mbas kalimit të afatit të ankimit regjistrohen në sistem rezultati përfundimtar. <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Gjatë takimit në institucion, GVJ konstatoi se studentëve u garantohet e drejta për të ankimuar notën pranë pedagogut të lëndës dhe për të marrë sqarimet e nevojshme lidhur me pikët e realizuara në vlerësim. Në këtë proces, një rol të rëndësishëm dhe proaktiv luan edhe koordinatori i programit të studimit, i cili ndërmjetëson dhe lehtëson komunikimin midis studentit dhe stafit akademik. <i>Pika 8 e nenit 28 Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në nenin 90 të Rregullores së Universitetit Barleti parashikohen procedurat për kërkesën e rishikimit të notës, afatet përkatëse për paraqitjen e ankesës, si dhe mënyrat e trajtimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të mundshme ndërmjet studentit dhe pedagogut. <i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i>
Konkluzione	<i>Në përfundim GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë viti/semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare, detyrave të kursit etj, sipas komponentëve të përcaktuar në sylabusin e lëndës dhe është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale (me shkrim, vlerësimin me gojë dhe i kombinuar) me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve)</i> <i>Testimi bëhet në përputhje me sylabusin dhe Departamenti garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Gjithashtu në Rregulloren e Institucionit parashikohet qartë procedura për rishikimin e notës, afatet për ankim dhe mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet studentit dhe pedagogut, me përfshirjen e rolit ndërmjetësues të Dekanit, Departamentit dhe mundësinë për ngritjen e një komisioni ad hoc.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë të formimit të përgjithshëm, karakterizues e plotësues të cilat synojnë përgatitjen e studentëve si profesionistë të kualifikuar në fushën e drejtësisë. Kurrikula është hartuar në funksion të zhvillimit të aftësive dhe kompetencave për të interpretuar dhe zbatuar ligjin, në përputhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian. Ajo synon gjithashtu formimin e ekspertëve të aftë për të trajtuar problematikat bashkëkohore nga një këndvështrim krahasues, në përputhje me sfidat kombëtare dhe zhvillimet europiane dhe globale. Syllabuset e lëndëve/modulëve paraqesin në mënyrë të qartë objektivat e mësimdhënies, rezultatet e të nxënit, si dhe aftësitë dhe kompetencat që studenti pritët të zhvillojë gjatë ndjekjes së lëndës përkatëse. Departamenti ofron edhe aktivitete mbështetëse përtej procesit të rregullt mësimor, siç janë orët e konsultimeve dhe leksionet e hapura, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e përvojës studentore. Nga takimet në institucion, GVJ konstaton gjithashtu se stafi akademik inkurajon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtëkurrikulare dhe kërkimore-shkencore. Gjithashtu, ofrohen mundësi për mobilitet studentor përmes programeve të shkëmbimit, të cilat synojnë rritjen e përvojës ndërkombëtare dhe përthithjen e praktikave më të mira në fushën e drejtësisë. <u>GVJ rekomandon</u> zgjerimin dhe strukturimin më të mirë të veprimtarive jashtëkurrikulare dhe kërkimore-shkencore, forcimin e partneriteteve ndërinstitucionale për programe shkëmbimi, si dhe intensifikimin e analizës së jurisprudencës në

Procurator



	procesin mësimor, me qëllim rritjen e përvojës praktike, kritike dhe ndërkombëtare të studentëve në fushën e drejtësisë. <i>Ev 3.08 Programet mësimore Pjesa 1, Pjesa 2 dhe 3;</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar dosjes së plotë të programit të studimit të paraqitur, si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve/modulëve janë të hartuar në shqip dhe në anglisht në përputhje me standardet akademike dhe përmbajnë në mënyrë të detajuar elementët përbërës të procesit mësimor. Konkretisht, ato pasqyrojnë qartë ndarjen sipas veprimtarive formuese, vlerësimin në kredite dhe orët përkatëse, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxënës, si dhe aftësitë dhe kompetencat që studenti pritët të fitojë. Të gjitha këto komponentë janë të harmonizuara me objektivat e përgjithshme të programit të studimit dhe kontribuojnë në arritjen e profilit të synuar të diplomantit. Gjithashtu, GVJ vlerëson se infrastruktura dhe ambientet fizike të institucionit garantojnë akses të mjaftueshëm dhe efektiv në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), duke e mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë realizimin e qëllimeve akademike të programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi". <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Ev 3.08 Programet mësimore Pjesa 1, Pjesa 2 dhe 3;</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbajtëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në dosje, si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Drejtësisë me anë të strukturave të tij monitoron zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve, në funksion të arritjes së objektivave të përgjithshme dhe specifike të programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi". Që në javën e parë të fillimit të semestrit, titullari i lëndës dhe stafi pedagogjik prezantojnë për studentët përmbajtjen kryesore të lëndës, çështjet kryesore që do të trajtohen gjatë zhvillimit të saj, literaturën bazë dhe ndihmëse, si dhe modalitetet e vlerësimit të njohurive, përfshirë format e kontrollit të vazhdueshëm dhe përfundimtar. Këto elementë janë të ndërlidhur me objektivat formues të programit dhe synojnë të

Arduxi

Ally

	sigurojnë ndjekjen sistematike të progresit të studentëve në përvetësimin e kompetencave profesionale dhe akademike.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit, si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se personeli akademik demonstroi njohuri të thelluara në fushën përkatëse dhe angazhohet në transmetimin e tyre në mënyrë efektive gjatë procesit mësimor. Orët e mësimi karakterizohen nga metoda interaktive, përfshirë prezantime, detyra kursi dhe analiza të rasteve konkrete nga praktika gjyqësore e gjykatave shqiptare dhe atyre europiane, me fokus të veçantë në zhvillimin e të menduarit kritik dhe aftësive praktike të studentëve. Gjithashtu, GVJ vlerëson se programi përfshin komponentin e praktikës mësimore, e cila është funksionale dhe në shërbim të objektivave të Departamentit të Drejtësisë. Megjithatë, konstatohet nevoja për intensifikimin e angazhimit të studentëve në klinikën ligjore, me qëllim fuqizimin e përvojës praktike dhe lidhjen më të drejtpërdrejtë me realitetin profesional. <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti t'i japë përparësi zhvillimit të mëtejshëm të klinikës ligjore përmes rritjes së përfshirjes aktive të studentëve dhe forcimit të bashkëpunimit me institucione të sistemit të drejtësisë dhe organizata partnere. Në këtë kuadër, <u>sugjerohet</u> nënshkrimi i marrëveshjeve të reja ndërinstitucionale me qëllim ofrimin e më shumë mundësive për praktika profesionale dhe për të nxitur mobilitetin akademik dhe profesional të studentëve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar. <i>Ev 2. 47 Cv Stafit akademik të programit të studimit;</i> <i>Ev 3.08 Programet mësimore Pjesa 1, Pjesa 2 dhe 3;</i> <i>Ev 2. 09Plani i aktiviteteve vjetore të veprimtarive të Departamentit të Drejtësisë;</i> <i>Ev 2. 35Trajnimeaktivitete Departamenti i Drejtësisë;</i> <i>Ev. 1.29. Strategjia e Nderkombetarizimit të UNIBA;</i> <i>Ev 2. 18Raport i përfitimeve mbi realizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit;</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me	Nga shqyrtimi i dosjes në DVV si dhe nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i dedikohet

Bonus



kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	nëpërmjet orëve të hapura dhe seminareve trajtimit të çështjeve të rëndësishme si dhe të zhvillimeve më të reja në fushën e të drejtës dhe merr pjesë rregullisht në projekte kërkimore e konferenca të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare. <i>Ev 2. 35Trajnimeaktivitete Departamenti i Drejtësisë;</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	GVJ konstaton se Departamenti i Drejtësisë dhe stafi i tij operon në një klimë akademike dhe infrastrukturore që favorizon zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimit shkencor. Ambientet e institucionit ofrojnë hapësira të përshtatshme dhe bashkëkohore për hartimin dhe realizimin e projekteve kërkimore, organizimin e konferencave shkencore, si dhe për zhvillimin e vizitave studimore dhe aktiviteteve të tjera me karakter akademik, në bashkëpunim të ngushtë me studentët. GVJ vlerëson gjithashtu se nxitja e kërkimit shkencor mbështetet nga politika institucionale të cilat përfshijnë mbështetje financiare për punën kërkimore të stafit akademik, si dhe për aktivitetet e klubeve studentore, duke krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillim profesional dhe akademik. GVJ inkurajon Departamentin e Drejtësisë dhe stafin e tij akademik të intensifikojnë bashkëpunimet në fushën kërkimore, përmes zgjerimit të partneriteteve me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe përmes realizimit të programeve të përbashkëta studimi me IAL simotra. <u>Rekomandohet</u> gjithashtu rritja e bashkëpunimit ndërfaqultete të Universitetit "Barleti", me qëllim zhvillimin e një kurrikule ndërdisiplinore dhe bashkëkohore. Kjo qasje do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe krijuese të studentëve, duke i inkurajuar ata të angazhohen në projekte inovative dhe të promovojnë punimet e tyre në aktivitete shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Ev 2. 43Të dhëna për financim të studentëve të programit për aktivitete kërkimore shkencore;</i>
Konkluzione	<i>Programi i integruar i ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale dhe shkencore të studentëve, duke u ofruar atyre një formim të avancuar në fushën e drejtësisë. Programi garanton rritjen e aftësive krijuese, analitike dhe zbatuese, si</i>

Boonik

[Signature]

	dhe aftësimin për të trajtuar çështje juridike komplekse në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me standardet bashkëkohore. Përmes integritit të njohurive teorike me përvojën praktike, programi kontribuon në formimin e juristëve të kualifikuar dhe të aftë për të vepruar në kontekste të ndryshme profesionale dhe institucionale. <u>GVJ rekomandon</u> që Departamenti i Drejtësisë të intensifikojë përfshirjen aktive të studentëve në klinikën ligjore dhe në veprimtari jashtëkurrikulare me karakter kërkimor e praktik, duke forcuar bashkëpunimin me institucionet e sistemit të drejtësisë, organizatat partnere dhe fakultetet e tjera brenda universitetit. Gjithashtu, <u>sugjerohet</u> zgjerimi i marrëveshjeve ndërinstitutionale dhe realizimi i programeve të përbashkëta studimi me IAL simotra, me qëllim rritjen e mundësive për praktika profesionale, mobilitet akademik dhe zhvillim të një kurrikule ndërdisiplinore bashkëkohore. Kjo qasje do të ndikojë në mënyrë domethënëse në zhvillimin e aftësive kërkimore, kritike dhe inovative të studentëve në fushën e drejtësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5


Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në dosjen e DVV-së dhe vizitës së zhvilluar në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe zbaton një udhëzim të qartë mbi procedurat dhe afatet për zhvillimin e provimeve formuese dhe mbrojtjen e temës së diplomës, i cili do të zbatohet në programin e integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi". Këto procedura dhe detyrime përmbyllëse për studentët janë të specifikuara gjithashtu në rregulloren përkatëse të programit të studimit.

Komiteti



	Nga konsultimet me studentët u konstatua se informacioni mbi modalitetet e vlerësimit, temat e diplomës dhe afatet përkatëse është i plotë, i qartë dhe lehtësisht i aksesueshëm. Ai u komunikohet studentëve si nga pedagogët e lëndëve, ashtu edhe nga strukturat administrative/ndihmëse të Departamentit. GVJ vlerëson gjithashtu se Departamenti i Drejtësisë ka në përdorim një dokument standard për mbrojtjen e provimit final, si dhe një set të mirëpërcaktuar rregullash që rregullojnë procesin e përzgjedhjes së temës, metodologjinë e kërkimit dhe ndërveprimin institucional midis studentit dhe pedagogut udhëheqës. <i>Ev 2. 26 Format vlerësimi i udhëheqësit shkencor;</i> <i>Ev 2.27 Paketa e Dipomit, Departamenti i Drejtësisë VA-24-25;</i> <i>Ev 2. 19Paketa e Praktikës;</i> <i>Ev 2. 20Paketa e Provës finale;</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Gjatë vizitës në institucion dhe veçanërisht në takimin e studentët në programin e integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi" u konstatua se si strukturat përgjegjëse ashtu dhe personeli akademik të këtij masteri janë të disponueshëm dhe vënë në dispozicion të studentëve të gjithë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve nga ana e studentëve në mënyrë të informuar dhe koherent me qëllimin e masterit. <i>Ev 2. 20Paketa e Provës finale;</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Gjatë vizitës në institucion dhe veçanërisht në takimin e studentët e programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi"u konstatua se komisioni i administrimit të provimit final bazohet në testimin e njohurive të testuara në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik. Kështu në bazë të rregullores së programit të studimit por edhe të syllbauseve të veçantë rregullohen qartë modalitetet e testimit të njohurive të dhëna gjatë vitit akademik dhe kreditet që përfiton studentimi nga dhënia e provimit në një lëndë të caktuar. <i>Ev 3.08 Programet mësimore Pjesa 1, Pjesa 2 dhe 3;</i>

	<i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjen e DVV-së dhe vizitës së zhvilluar në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar një udhëzim të detajuar mbi procedurat që lidhen me përzgjedhjen e temës së diplomës, procesin e udhëheqjes akademike dhe monitorimin e progresit të punimit nga ana e pedagogut udhëheqës dhe departamentit. Gjithashtu rregullorja e këtij programi studimi ka të qarta standardet që duhet të plotësojë punimi final, me theks të veçantë në respektimin e etikës akademike dhe evitimin e çdo forme plagjiature. Studentët janë të udhëzuar të paraqesin një punim përfundimtar në përputhje me kriteret e përcaktuara metodologjike, teknike dhe përmbajtësore, duke reflektuar aftësitë kërkimore dhe përpunuese të zhvilluara gjatë programit të studimit. <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Ev 2.27 Paketa e Dipomimit, Departamenti i Drejtësisë VA-24-25;</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjen e DVV-së dhe vizitës së zhvilluar në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Drejtësisë ka të qartë rëndësinë e mbështetjes së strukturuar akademike për studentët gjatë procesit të hartimit të temës së diplomës. Kjo mbështetje realizohet nëpërmjet konsulencave të rregullta me pedagogët udhëheqës, sesioneve orientuese mbi metodologjinë e kërkimit shkencor dhe trajnimeve të dedikuara për ruajtjen e integritetit akademik dhe përgatitjen e punimeve përfundimtare në përputhje me standardet e përcaktuara shkencore dhe etike. Gjithashtu, GVJ vlerëson pozitivisht që, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara nga Universiteti "Barleti" me institucione dhe organizata të tjera, studentëve u krijohen mundësi për të pasur akses në burime empirike dhe mbështetje praktike për ndërtimin e punimeve kërkimore me natyrë analitike dhe profesionale. <u>GVJ rekomandon</u> intensifikimin e bashkëpunimeve ndër-institucionale brenda dhe jashtë vendit, me qëllim zgjerimin e mundësive për angazhimin praktik të studentëve në projekte kërkimore, si dhe sigurimin e efektivitetit të zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese, duke garantuar që përfitimet

Konungj

NGJ

	konkrete të tyre të reflektohen drejtpërdrejtë në cilësinë e përgatitjes akademike dhe profesionale të studentëve. <i>Ev 2. 24 Marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit në shkruar vitet e fundit;</i> <i>Ev 2. 38 Konkursi rajonal i FD nga studentët e programit të integruar të studimeve MSH në Drejtësi;</i> <i>Ev 2. 34 Praktike aktivitetet me studente Alumni ndër vite (promovimi i librit Mustafa Llani);</i> <i>Ev 2. 37 Raporti mbi zbatimin e projektit dhe studimit mbi perceptimin e qytetarëve lidhur me ndikimin e Ligjit për Ndihmën Juridike Falas në Shqipëri;</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Sipas Rregullores së Universitetit Barleti dhe Rregullores së programit mësimor, studentët në përfundim të provimit përfundimtar do të vlerësohen me sistemin prej dhjetë notash ku nota nga e pesë e lartë janë kaluese. Gjithashtu në formatin e kontrollit të dijeve me shkrim përdoret dhe sistemi i realizimit të pikëve që përkthehet në notë. <i>Ev 3.01 Rregullore e programit të studimit;</i> <i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit të programit të integruar të ciklit të dytë studenti do të pajiset me diplomën "Master i shkencave" në "Drejtësi" konform përcaktimeve të parashikuara tek neni 97 i Rregullores së Universitetit 'Barleti'. <i>Ev. 1.02. Rregullore e UNIBA;</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti	Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se Sekretaria mësimore ruan kopje të dokumentacionit të studentit pasqyruar në: - Regjistrin themeltar (bazë) të studentëve me të dhënat personale të tyre;

Kosova

[Signature]

informacione për studentin nëse kërkohen.	- Regjistrin e arritjeve akademike me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit; Këto regjistra mund të konsultohen nga student i cili me kërkesë të tij mund të pajiset me një kopje të dokumentacionit të kërkuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>Ev. 1.11. Rregullore për funksionimin e Sekretarise Mesimore;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar dhe ndjek një procedurë të qartë për detyrimet përmbyllëse të studentëve në programin e studimit, duke siguruar dokumentacionin e nevojshëm dhe mbështetjen përkatëse për realizimin e tyre.</i> <i>GVJ konstaton se ky kriter është përmbushur në nivelin formal dhe procedural; megjithatë, duke qenë se ky është viti i parë në të cilin institucioni do të diplomojë studentë të programit të integruar të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi", zbatimi i plotë i kësaj procedure do të vlerësohet më mirë në praktikë pas përfundimit të këtij cikli.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N / A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet,	N / A

Krasni

M. K.

garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.				
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N / A			
Konkluzione	GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Howe!

Ally

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																																												
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Zyra e Burimeve Njerëzore në Universitetin Barleti ishte struktura përgjegjëse për mbledhjen, për ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Personeli akademik dhe ndihmës akademik kanë dosjet e tyre personale me të dhëna të plota. Nga CV-të (<i>Evidenca 2. 47 CV Stafit akademik</i>) e shqyrtuara rezultojnë se personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit, i përmbush <u>kryesisht</u> kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Referuar (<i>Ev 2. 1. Te dhëna për stafin në program për 5 vite tab 6 dhe 7</i>) numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi për pesë vite akademike është si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td><td>4</td><td>1</td><td>3</td><td>1</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>2</td><td>6</td><td>4</td><td>6</td><td>1</td><td>7</td><td>1</td><td>4</td><td>2</td><td>4</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>3</td><td>1</td><td>6</td><td>1</td><td>3</td><td>2</td><td>4</td><td>3</td><td>2</td><td>5</td></tr><tr><td>Totali</td><td>7</td><td>8</td><td>12</td><td>9</td><td>8</td><td>10</td><td>8</td><td>8</td><td>8</td><td>10</td></tr></table> Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 dhe udhëzimet që burojnë prej tij, në programet e ciklit të dytë, mësimdhënia duhet të realizohet nga staf akademik që mban të paktën gradën doktor në fushën përkatëse të mësimdhënies. <i>GVJ konstaton se:</i> ▪ për vitin akademik 2020-2021 26.6 % e stafit janë me Msc; ▪ për vitin akademik 2021-2022 33.3 % e stafit janë me Msc; ▪ për vitin akademik 2022-2023 27.7 % e stafit janë me Msc; ▪ për vitin akademik 2023-2024 43.7 % e stafit janë me Msc; ▪ për vitin akademik 2024-2025 33.3 % e stafit janë me Msc;	Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1	Prof. Asoc.	2	1	2	1	4	1	3	1	4	-	Dr./PhD.	2	6	4	6	1	7	1	4	2	4	Msc.	3	1	6	1	3	2	4	3	2	5	Totali	7	8	12	9	8	10	8	8	8	10
Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025																																																																				
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																			
Prof.Dr.	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1																																																																			
Prof. Asoc.	2	1	2	1	4	1	3	1	4	-																																																																			
Dr./PhD.	2	6	4	6	1	7	1	4	2	4																																																																			
Msc.	3	1	6	1	3	2	4	3	2	5																																																																			
Totali	7	8	12	9	8	10	8	8	8	10																																																																			

Koumji

[Signature]

	<i>Për sa më sipër <u>GVJ rekomandon</u> që institucioni duhet të marrë masat që në mësimdhënien e këtij programi studimi të angazhohet vetëm staf akademik me kualifikimin doktor shkencash e lart, sipas nenit 59, pika 6 Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ referuar informacionit të deklaruar konstaton se raporti i ngarkesës mësimore për programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi” është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. (Evidenca 2. 29 Ngarkesa totale e personelit akademik). Ngarkesa mësimore mbuluar nga personeli akademik me kohë të plotë për programin në fjalë për vitin akademik 2024 – 2025 është 72.3%, ndërkohë që personeli akademik me kontratë mbulon 27.7% të programit. Ndërkohë ky raport sipas viteve akademike ka qenë si më poshtë: 2022 - 2023: Ngarkesa mësimore mbuluar nga PAE:78%; 2023 - 2024: Ngarkesa mësimore mbuluar nga PAE:74.17%; 2024 - 2025: Ngarkesa mësimore mbuluar nga PAE: 72.3% ; (Evidenca 2. 56 Plani mesimore i lidhur me stafin akademik përkatës).
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Lidhur me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit konstatohet se ka të dhëna që dëshmojnë stabilitet dhe qëndrueshmëri. Departamenti që mbështet kete program studimi përbëhet si nga staf i vjetër me ekperiencë mbi 5 vjeçare, ashtu edhe nga stafi i ri me grada dhe tituj. Bazuar në dokumentacionin e IAL-se mbi punësimin, personeli akademik punësohet me kontratë të pacaktuar në linjë me gradat shkencore dhe titujt akademik që ato kanë, në bazë të cilës ato nënshkruajnë dhe kontratën e punës. (Evidenca 1. 15 Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore). (Evidenca 2. 58 Format i dosjes së personelit të stafit).
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e	Referuar dokumentacionit të siguruar nga burimet njerëzore, si dhe nga të dhënat në faqen zyrtare të IAL-se, rezultojnë se procedurat e rekrutimit të personelit bëhen transparente. Ka një procedurë rekrutimi të rregulluar nga aktet e brendshme të IAL-së (dokumenti “Manual i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”), e

Konurci

[Signature]

që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	cila përfundon me një kontratë pune, të lidhur midis IAL dhe punonjësit të rekrutuar. Punonjësi i rekrutuar depoziton pranë burimeve njerëzore dosjen me dokumentacionin, përpara lidhjes së kontratës së punës, sikurse specifikohet në formatin e dosjes së personelit të stafit. Përzgjedhja e pedagogëve që japin një lëndë të caktuar është realizuar duke marrë në konsideratë kualifikimin dhe ekspertizën akademike/kërkimore shkencore të pedagogut, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit të studimit. <i>(Evidenca 1. 15 Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore).</i> <i>(Evidenca 2. 58 Format i dosjes së personelit të stafit)</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Specifika e programit të studimit “PIND MSH në Drejtësi”, nuk kërkon zhvillimin e vazhdueshëm të orëve laboratorike, si pjesë të ngarkesës mësimore. Në raste të veçanta studentët kanë zhvilluar vizita në laboratorë të posaçëm, jashtë IAL-së, sikurse është rasti i vizitës në laboratorin e Institutit të Policisë Shkencore, në kuadër të zhvillimit të lëndës së kriminalistikës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi gjithashtu se, nëpërmjet laboratorit të informatikës dhe pajisjeve të tjera të teknologjisë së informacionit, IAL plotëson nevojat e studentëve të këtij programi studimi, për pajisje kompjuterike dhe rrjete, për aq sa kanë nevojë, nëse ata duan ti shfrytëzojnë ato për procesin mësimor, apo për kërkimor-shkencor. <i>(Evidenca 2. 60 Të dhënat të plotë për infrastrukturën në funksion të programit të studimit).</i> <i>(Evidenca 2. 45 Vizitë mësimore në Institucionin e Policisë Shkencore).</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të	Nga takimi me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit, si dhe me Zyrën e Burimeve Njerëzore, rezultoi se IAL mbledh dhe ruan një bazë të dhënash, mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi. Një rol të rëndësishëm këtu ka Zyra e Burimeve Njerëzore e IAL, e cila disponon dosje dhe të dhëna statistikore për personelit e programit të studimit dhe angazhimin e tij gjatë çdo semestri të vitit akademik.

Koumari

[Signature]

përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Administrohen raportimet semestrale të çdo pedagogu, në lidhje me aktivitetet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. <i>Tabelat 1 dhe 2 Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA).</i> <i>Evidenca 2.15 Format i raportimit të punës semestrale;</i> <i>Evidenca 2.16 Raporti i performancës së stafit akademik;</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Referuar dokumentacionit për këtë program studimi, rezultojnë se IAL ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional me institucione të tjera të arsimit të lartë apo organizata të tjera, me objekt “Fuqizimi i sektorit dhe i profesionistëve; Zhvillimi i burimeve njerëzore; Kërkimi i aplikuar dhe inovacionit; Ngritjen dhe realizimin e projekteve” (Evidenca 2.24 Marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit). Megjithatë duhet evidentuar fakti se, në funksion të organizimit të praktikave mësimore, numri i këtyre marrëveshjeve është i vogël. Kështu rezultojnë vetëm 2 marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, 1 Marrëveshje me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit dhe 1 Marrëveshje me një studio avokatie. Ka patur shkëmbim korrespondence edhe me institucione të tjera, në funksion të organizimit të praktikës mësimore (si Bashkia Tirane, Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shetit, Gjykatat, etj.) por nuk disponohen marrëveshje midis IAL-së dhe këtyre institucioneve që do të garantojnë një marrëdhënie të qëndrueshme për disa vite. (Evidenca 2. 11 Korrespondenca për realizimin e praktikës); <i>Rekomandohet përfundimi i marrëveshjeve me këto institucione, më të cilat janë shkëmbyer korrespondencat përkatëse.</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të	Gjatë periudhës së realizimit të intervistës nga GVJ, studentët e programit të studimit në vlerësim (PIND Drejtësi) ende nuk e kishin përfunduar praktikën profesionale, por ishin caktuar në institucionet pritëse dhe u ishte caktuar pedagogu mentor. Procedura e realizimit të praktikës është e rregulluar në mënyrë të detajuar në aktet e brendshme të IAL-së (Paketa e Praktikës).

ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Sipas formateve bashkëngjitur këtij dokumenti hartohet një Marrëveshje e Praktikës, e cila nënshkruhet nga studenti praktikant, pedagogu mentor dhe personi përgjegjës i institucionit pritës. Këti identifikohen të dhënat e praktikantit dhe institucionit pritës, të gjitha detyrimet e studentit në lidhje me objektivat e praktikës, produkti i praktikës dhe mënyra e vlerësimit të tij. Raporti i praktikës që duhet të hartohet nga studenti është format standart i detajuar. Vlerësimi i praktikës bëhet me tre formate nga vetë studenti, nga institucioni pritës, si dhe nga pedagogu udhëheqës i praktikës, duke vlerësuar të gjithë komponentët e praktikës së kryer. (Evidenca 2. 19 Paketa e Praktikës), Në mbarim të praktikës studentët vlerësohen nga pedagogu mentor si dhe komisioni i ngritur pranë departamentit. (Evidenca 2. 28 Vendimi për ngritjen e komisionit të vlerësimit të praktikës).			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi për vitet akademike 2020-2024 ka kryesisht nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mësime në programe studimi Master.</i> <i>GVJ rekomandon që institucioni duhet të marrë masat që në mësime të këtij programi studimi të angazhohet vetëm staf akademik me kualifikimin doktor shkencash e lart, sipas nenit 59, pika 6 Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë".</i> <i>Gjithashtu IAL duhet të nënshkruajë më shumë marrëveshje me institucione shtetërore për të garantuar një marrëdhënie të qëndrueshme për realizimin e praktikave mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Bonum

[Signature]

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Godina ku zhvillon aktivitetin e mësidhënies Departamenti i Drejtësisë, ndodhet në Kampusin 2 të IAL (UniBA), në Rrugën Frang Bardhi. Kjo godinë është e re (duket vizualisht) dhe mjediset e saj janë të mjaftueshme për të zhvilluar leksionet dhe seminarët për këtë program studimi (PIND Drejtësi). Nga vëzhgimi i shpejtë gjatë vizitës, u evidentua se institucioni ofron mjediset e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, leksioneve dhe seminareve. Sallat ku zhvillohet procesi mësimor kanë hapësirat e nevojshme për studentët, kanë ajrim dhe ndriçim të duhur, me dritare që hapen dhe mbyllen, dhe janë të pajisura të gjitha me tavolina dhe karrige, që mundësojnë qëndrimin e një numri të konsiderueshëm njerëzish (student dhe staf). Gjithashtu studentët kanë ambjent të përshtatshëm për rekreacioni dhe pushimi. Institucioni ka sistemin e mbrojtjes nga zjarri, si dhe ajrim e kondicionuar. <i>(Evidenca 2.60 Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit).</i> <i>(Evidenca 2.62 Të dhëna tabelore, Mjediset e Fakultetit/Njesisë Bazë).</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	FEQD dhe Departamenti i Drejtësisë që ofrojnë programin e studimit disponojnë auditore për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë interneti, të pajisura me infrastrukturën bazë mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerëzore, IT, Biblioteka janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre. E gjithë godina mbulohet nga rrjet interneti eifi, të disponueshme për të gjithë. Ambjentet ku zhvillohej mësimi ishin të pajisura me kompjuter, videoprojektor, smartboard dhe sisteme projektimi digjital, tabelë për të shkruar. <i>(Evidenca 2.62 Të dhëna tabelore, Mjediset e Fakultetit/Njesisë Bazë).</i> Biblioteka gjithashtu ishte e pajisur me kompjutera dhe internet, duke afuar mundësi të navigimit on line <i>(Evidenca 1. 21 Të dhënat e plota për platformat on line).</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit,	Programi i studimit realizohet në 1 godinë -ku sigurohet hapësirë të përshtatshme, të tilla si: laboratore, klasa, zyra dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni, siç janë: videoprojektorët, kompjuteret dhe interneti për të realizuar

përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	programin e studimit. Auditorët janë të pajisura me tabela dhe në çdo klasë ka të instaluar pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, si: PC, videoprojektor, TV, kamera dixhitale dhe pajisje CD. Rrjeti i internetit është shtrirë në të gjithë mjediset mësimore. <i>(Evidenca 2.62 Të dhëna tabelore, Mjediset e Fakultetit/Njesisë Bazë)</i> <i>(Evidenca 1. 21 Të dhënat e plota për platformat on line)</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni disponon pajisje dhe aparatura të cilët vihen në përdorim të studentëve sipas kërkesave të tyre për realizimin e detyrave të kursit ose edhe për aktivitete të tjera jashtëshkollore dhe aktivitete të ndryshme studentore. Laboratori i teknologjisë së informacionit është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike, të aksesueshëm për të gjithë studentët. Laboratori ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në disa aplikacione dhe programe teknologjike si E-student, Teams, Jetstore, Classroom, ESC apo dhe Office 365 etj. <i>(Evidenca 1.26 Udhëzues për përdorimin e strukturës së TIK)</i> <i>(Evidenca 1. 21 Të dhënat e plota për platformat on line)</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e	Nga takimi në institucion, GVJ u informua se studentët kryesisht për realizimin e praktikës akomodohen në institucionet e përzgjedhura prej tyre dhe vihen nën mbikqyrje nga një jurist, i cili ushtron aktivitet në këto institucione. Është pikërisht mbikqyrësi, i cili më pas realizon dhe një vlerësim mbi ecurinë e praktikës mësimore në institucion. E gjithë procedura e praktikës është e mbështetur dhe në dokumentacionin përkatës të miratuar në Departament.

Koumari

A/Cy

programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	<i>Procesi mësimor në Programin e Integruar të studimit "Master i Shkencave në Drejtësi" ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra dhe një sallë laboratorit të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënit. Të gjitha këto ambiente janë të pajisura me mjetet e nevojshme, përfshirë ato të teknologjisë së informacionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse kryesisht vihet në dispozicion të studentëve nëpërmjet bibliotekës, si dhe nëpërmjet përdorimit të platformës Teams, nëpërmjet të cilës pedagogu krijon klasën virtuale. Studentët kanë bibliotekën fizike dhe online. Biblioteka e IAL është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaja në përputhje me natyrën e programeve të studimit. Menaxhimi i librave në bibliotekë bëhet nëpërmjet një platforme dixhitale. I gjithë procesi është i automatizuar që nga regjistrimi deri tek tërheqja e librit (https://biblioteka.umb.edu.al). (Evidenca 2. 61 Platforma e bibliotekës on line) Evidentohen kërkesat për shtim literature fizike në funksion të realizimit të programit të studimit PICD "MSH në Drejtësi". Sa i përket literaturës në formë elektronike rezulton se për nevojat e studentëve janë vënë në dispozicion disa platforma elektronike

Boonw

MG

	si EBSCO Open Dissertation dhe DOAJ (Directory of Open Access Journals), JSTORE etj, të cilat mund të lehtësojnë aksesin në burime bibliografike të viteve të fundit. Burimet e literaturës online aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët e këtij programi studimi.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti i Drejtësisë si njësia përgjegjëse, ka përcaktuar kriteret që duhet të plotësojnë tekstet që do të renditen në literaturën bazë të detyruar të miratimit në departament. Duke iu referuar dokumentacionit të shqyrtuar si dhe shënimeve në institucion rezulton se bëhet përditësimi i titujve të librave në bibliotekë (<i>Evidenca 2. 65 Korrespondencë për pasurimin e bibliotekës me tituj librash</i>).
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjate vizitës në Institucion, u konstatua se është në dispozicion të studentëve biblioteka e Universitetit Barleti, e cila ndodhej në katin e 1-rë. Biblioteka ofronte hapsirë dhe poste leximi të përshtatshme, si dhe poste me kompjutera, për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare. Pozicioni i bibliotekës dhe orari i saj garantonte mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. (Tabelat përmbledhëse ankes RVB "Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16); "Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17)
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e	Biblioteka ishte e pajisur edhe me libra e revista shkencore në fushën e drejtësisë. Kjo u konstatua nga vizita në ambjentet e bibliotekës nga GVJ. Nëse i referohemi <i>Evidencës nr.2.65 "Korrespondencë për pasurimin e bibliotekës me tituj librash"</i> , rezulton se për programin e studimit PIND "Drejtësi", pra në fushën e drejtësisë janë në dispozicion 196 Tituj librash fizikisht (në shqip dhe gjuhë të huaj). Këto tituj janë të mjaftueshëm për të mbuluar modulet e veprimtarive mësimore, në këtë program studimi. Ndërkohë që totali i titujve në të gjitha ambjentet e IAL-së (salla e Bibliotekës, salla Pit Stop, Holli i Triple City, dhe Holli i Universitetit) është me i madh.

Komisi

[Signature]

specifikës së programit të studimit.	(Evidenca nr.2.65 "Korrespondencë për pasurimin e bibliotekës me tituj librash").
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Përdorimi i bibliotekës së universitetit bëhet nëpërmjet platformës on line: https://umb.edu.al/biblioteka.html. Studentëve u ishte krijuar mundësia për të aksesuar në disa biblioteka online, si: biblioteka digjitale EconBiz; biblioteka digjitale JSTOR, duke pasur akses në shumë artikuj të revistave akademike, libra, punime akademike, etj. IAL ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së këtij programit të studimit. Kapacitetet e bibliotekës garantojnë mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Biblioteka Universitare ka të instaluar falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj, i cili ofronte një version të avancuar në kërkimin e informacionit. https://biblioteka.umb.edu.al/ (Evidenca 2. 61) (Evidenca 2. 61 Platforma e bibliotekës on line)
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizitat në institucion rezulton se Biblioteka e IAL- së është e pajisur me poste leximi dhe pajisje kompjuterike, që siguron shfrytëzimin nga të gjithë studentët. Përdorimi i bibliotekës së Universitetit Barleti bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online. Gjithë procesi i shërbimit bibliotekar është i automatizuar nisur që nga regjistrimi dhe deri në dorëzimin e librit. Rregjistrimi i studentëve bëhet duke u paraqitur vetë ata fizikisht në sallën e bibliotekës ose duke dërguar një email në adresën library@umb.edu.al me kërkesën që të bëhet regjistrimi i tij. Pasi është kryer procesi i regjistrimit në sistem, studenti mund të aksesojë sistemin me anë të adresës së emailit. Studentët apo staf i akademik, përmes kësaj llogarie personale të krijuar, mund të hyjnë në platformë dhe nga ëeb faqe e bibliotekës dhe mund të bëjnë kërkimin e librit, apo të rezervojnë për të.

Krowci

Al G

	<i>(Evidenca 1. 21 Të dhënat e plota për platformat online/Struktura e teknologjisë informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj.).</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Sipas njoftimit të publikuar në ambjentet e bibliotekës dhe Rregullorës së Bibliotekës, dispozita “Orari”, orari i hapjes dhe mbylljes së bibliotekës fizikisht ishte nga ora 08.00 – 19.45. Ky orar është në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre. Studentët dhe stafi akademik i Universitetit Barleti kishin mundësi që nëpërmjet platformës digjitale të menaxhimit të librit të bënin kërkimin e titujve të librave që ndodhen në bibliotekë, kërkimin e librave elektronikë dhe punimet e diplomave, edhe kur ata nuk janë fizikisht në ambjentet e universitetit. <i>(Evidenca 1. 12 Rregullore e Bibliotekës)</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	GVJ konkludon se njësia përgjegjëse për programin dhe biblioteka periodikisht kanë hartuar kërkesat për përditësimin e fondit fizik, të cilat nuk janë përmbushur në masën e duhur nga institucioni. Përsa i përket fondit të librave online ai është rritur dhe përditësuar, kjo dhe falë bashkëpunimeve dhe projekteve kështu biblioteka dixhitale EBSCO host numëron akses në një mori platformash online me një fond të pakushtëzuar dhe të përditësuar. Gjithashtu edhe aksesit i pakushtëzuar në JSTORE garanton akses shumë shumë të mirë revista shkencore, mijra libra, qindra raporte në fushën e Drejtësisë dhe shkencave shoqërore. Nga takimi me personelin akademik na u konfirmua fakti se për marrjen e gradave dhe titujve akademik kanë pasur lehtësira dhe ndihmesë nga institucioni, jo vetëm me lehtësirat për shfrytëzimin e materialeve, por dhe me financimin e pjesëmarrjeve dhe e botimeve shkencore në këto revista me faktor impakti.
Konkluzione	<i>Literatura bazë dhe ndihmëse e nevojshme për programin e studimit PICD “MSH në Drejtësi”, vihet në dispozicion të</i>

Koan

11/4

	studentëve. Kjo literaturë përditësohet dhe është në dispozicion të studentëve nëpërmjet bibliotekës fizike dhe asaj online.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	IAL administrojnë dhe menaxhojnë të dhënat dhe dokumentacionin që lidhet me studentët nga regjistrimi i tyre, deri në momentin e diplomimit. Gjithashtu administrojnë dhe menaxhojnë dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor dhe gjithë ciklin akademik deri në përfundimin e programit të studimit. Për të mundur administruar të dhënat e studentëve, gjatë gjithë ciklit akademik, funksionon Sekretaria Mësimore. Kjo strukturë ushtron kompetencat e saj në përputhje me një rregullore të posaçme, Rregullorja e Sekretarisë Mësimore (<i>Evidenca nr.1.11</i>) dhe luan një rol thelbësor në ofrimin e informacionit të nevojshëm dhe mbështetjes për studentët që nga momenti i regjistrimit deri në përfundimin e studimeve. Nga verifikimi në Sekretarinë Mësimore u konstatua se në lidhje me këtë program studimi, pranë Sekretarisë Mësimore administrohen regjistrat si vijon: • Regjistri themeltar i studentëve; • Regjistri i arritjeve akademike; • Regjistri i të diplomuarve; Procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimit të studimeve, janë të parashikuara në një rregullore/manual të posaçëm. (<i>Evidenca 1. 14 Manuali "Rekrutim-Aplikim-Regjistrimi-Transferim i studentëve"</i>).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit	Nëpërmjet Rregulloreve të brendshme, IAL ka mundur funksionimin e strukturave që administrojnë dhe menaxhojnë të

Kosumi

Ala

administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	dhënat, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, atij mbështetës dhe aktorëve të tjerë të angazhuar në programin e studimit. Strukturat që menaxhojnë këtë informacion janë njësia bazë, struktura e Burimeve Njerëzore, Sekretaria e Përgjithshme, Sekretaritë Mësimore, Zyra e Matjes dhe Vlerësimit të Performancës, si edhe Zyra e Menaxhimit të Logjistikës dhe Operacioneve. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për ruajtjen e proces verbaleve dhe regjistrave ku pasqyrohen të dhënat mbi realizimin e procesit mësimor nga personeli akademik efektiv ose me kontratë. Zyra e Burimeve Njerëzore administron dokumentacionin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe atij administrativ të angazhuar në programin e studimit. Aktet e brendshme kanë të përcaktuara qartë detyrat, funksionet si dhe sistemin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet strukturave, duke mundësuar një sistem efikas të administrimit dhe menaxhimit të informacionit. <i>(Evidenca 1.02 Rregullore e UNIBA).</i> <i>(Evidenca nr.1.11 Rregullorja e Sekretarisë Mësimore)</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Akresi në sistemin e menaxhimit të IAL është i organizuar në mënyrë të strukturuar dhe nëpërmjet platformës dixhitale u mundëson të gjithë pjesëtarëve të personelit hyrje përmes kredencialeve të personalizuar, të cilat përcaktohen në bazë të funksionit dhe pozicionit të tyre në institucion. Edhe studentët kanë akses të dedikuar në sistem, përmes të cilit mund të gjenerojnë vërtetime për ndjekjen e studimeve, të shikojnë listën e notave, të informohen mbi rezultatet e provimeve dhe të monitorojnë në kohë reale situatën e pagesave vjetore. Ky akses kontrollohet dhe sigurohet nëpërmjet hyrjes në sistem me kredenciale personale, si përmes rrjetit të brendshëm (intranet), ashtu edhe përmes platformave online, në përputhje me kategorinë përkatëse të përdoruesit.
	<i>(Evidenca 1.26 Udhëzues për përdorimin e strukturës së TIK);</i> <i>(Evidenca 1.30 Të dhëna nga Intranet i UniBA).</i>

Boulli

[Signature]

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	IAL ka vënë në dispozicion një platformë digjitale për menaxhimin e të dhënave studentore – portali studentor – i aksesueshëm në adresën: https://studentportal.umb.edu.al/ Kjo platformë i mundëson studentëve të marrin informacion në kohë reale mbi rezultatet akademike, të dhënat e lektorëve dhe informacione të tjera të rëndësishme për rrugëtimin e tyre universitar (<i>Evidenca 2. 64 Portali studentor</i>). Referuar në evidencat dhe bazuar në gjetjet nga takimet e zhvilluara në institucion, GVJ konstaton se IAL ka siguruar mjete të avancuara për komunikim të brendshëm interaktiv mes stafit akademik dhe studentëve. Përveç portalit studentor, institucioni përdor edhe platforma të tjera digjitale si Microsoft Teams dhe Google Classroom, të cilat ofrojnë akses të gjerë në informacione të rëndësishme. Këto platforma mbështesin funksione të ndryshme si: regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses në literaturën mësimore, regjistrimi dhe administrimi i provimeve, vlerësimet nga pedagogët dhe rezultatet përfundimtare të lëndëve. Gjatë takimeve, si stafi akademik ashtu edhe studentët konfirmuan se komunikimi dhe shpërndarja e informacionit zhvillohen në kohë reale nëpërmjet këtyre sistemeve digjitale të menaxhimit.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit në IAL mundëson raportim të vazhdueshëm dhe të menjëhershëm mbi aktivitetet akademike dhe administrative. Nëpërmjet sistemit të portalit studentor bëhet i mundur shpërndarja e materialeve mësimore, komunikimin në kohë reale midis studentëve dhe pedagogëve, por edhe monitorimi i veprimtarisë akademike dhe gjithë komponentëve të procesit të mësimdhënies. Strukturat hierarkike mund të monitorojnë procesin akademik si dhe përmbushjen e detyrimeve në raport me procesin e mësimdhënies nga ana e pedagogëve. Gjithashtu monitorimi realizohet në përputhje me kompetencat e përcaktuara në aktet e brendshme, edhe nga struktura të tjera si NJSBC në kuadrin e proceseve të vetvlerësimit. Të gjitha aspektet që lidhen me procesin mësimor, janë pjesë e raporteve mujore të angazhimit të personelit akademik, të cilat përmbledhen në Raportin Vjetor të monitorimit. Për sa i takon aktivitetit të strukturave administrative dhe ndihmëse, monitorimi i veprimtarisë së tyre realizohet nga

Ascal

ALG

	autoritet drejtuese në përputhje me kompetencat e përcaktuara në aktet e brendshme. Këto struktura janë gjithashtu pjesë e proceseve vlerësuese në kuadrin e sistemit të vetvlerësimit. Sistemi siguron monitorimin elektronik të hyrje-daljeve në ambientet e institucionit. Gjithashtu, monitorimi mbështetet në raportet mujore të angazhimit të personelit akademik dhe administrative. <i>(Evidenca 2. 64 Portali studentor);</i> <i>(Evidenca 1.02 Rregullore e UNIBA);</i> <i>(Evidenca 1.06 Raporti vjetor i Monitorimit dhe Sigurimit të Cilësisë);</i> <i>(Evidenca 1.07 Rregullore e Nj.Zh.K.C);</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Komunikimi me publikun, në lidhje me informacionet mbi programin e studimit dhe aktivitetet e ndryshme, realizohet përmes faqes zyrtare të universitetit, mediave sociale (Facebook, Instagram, YouTube dhe Tëitter) dhe kanaleve të tjera informuese Faqja zyrtare e internetit të institucionit ëë.umb.edu.al është e mirëstrukturuar dhe përditësohet periodikisht, duke siguruar informacionin e nevojshëm për organizimin institucional, programet e studimit, aktivitetet e ndryshme dhe të dhënat e stafit akademik, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze. <i>(Evidenca 1.31 Procedurat dhe standartet për publikimet në rrjete sociale);</i> <i>(Evidenca 1.32 Procedurat dhe standartet për publikem në ëëb).</i>
Konkluzione	<i>Institucioni disponon një sistem të menaxhimit të informacionit, ku krijohen, ruhen dhe përditësohen të dhëna për studentët nga regjistrimi deri në diplomimi, për stafin akademik dhe administrativ, si dhe për aktivitetet e realizuara në funksion të përmbushjes së detyrimeve të programit.</i> <i>Sistemi përfshin edhe një platformë elektronike bashkëkohore, i cili siguron akses dhe raportim të vazhdueshëm dhe të menjëhershëm mbi aktivitetet akademike dhe administrative.</i>

Konkluzioni

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni mbështet financiarisht të gjitha programet e studimit që ofron, si dhe pasqyron gjendjen e tij financiare. Sipas kompetencave të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore, struktura të tilla si, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit ushtrojnë edhe kompetenca në fushën financiare. Këto struktura planifikojnë përdorimin e të ardhurave në nivel fakultetesh dhe departamentesh nëpërmjet hartimit dhe miratimit të buxhetit vjetor ku përcaktojnë nevojat lidhur me mbarëvajtjen e të gjitha programeve të studimit, përfshirë edhe programin PIND Drejtësi. Mbikqyrja e përdorimit të burimeve financiare dhe shpenzimeve, finalizohet çdo vit nëpërmjet miratimit të një raporti financiar të detajuar mbi kostot e programeve të studimit. Shpenzimet kryesore janë ato për paga (89.1%) ndërsa pjesa tjetër shpenzohet për aktivitete shkencor, projekte, etj. <i>(Evidenca 2. 63 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit)</i> <i>(Evidenca 2. 69 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vietet e fundit (Tabela 18))</i>

Komisi

Ally

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstaton se IAL harton dhe miraton një plan vjetor të financimit, i cili përmbush në mënyrë të plotë të gjitha elementet përbërëse të një programi studimi, si dhe administron të gjitha hallkat që lidhen me menaxhimin financiar. Në hartimin e projekt buxhetit konsiderohen nevojat e njësive kryesore dhe njësive bazë për financimin e programeve të studimit, përfshirë edhe programin PIND Drejtësi. Për të garantuar zhvillimin e pandërprerë të programit të studimit PICD “MSH në Drejtësi”, institucioni siguron të ardhura nga burime të ndryshme, përfshirë tarifat e shkollimit dhe pagesat gjatë periudhës së studimeve, si dhe të ardhura nga konsulenca, ofrimi i shërbimeve profesionale, shërbime trajnuese për kualifikimin e vazhdueshëm, etj. Sipas Pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve për vitin akademik 2023-2024, pjesa më e madhe e të ardhurave (mbi 95%) sigurohet nga tarifat e shkollimit, ndërsa pjesa tjetër nga të ardhura të tjera të shfrytëzimit. <i>(Evidenca 2. 63 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit)</i> <i>(Evidenca 2. 69 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vjetet e fundit (Tabela 18))</i>; <i>(Evidenca 2. 70 Projekt - Buxheti).</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ ka konstatuar se, në përputhje me legjislacionin e brendshëm mbi arsimin e lartë, kontabilitetin, si dhe standartet e raportimit dhe kontrollit financiar, institucioni zbaton në mënyrë të rregullt procesin e auditimit të brendshëm, i cili përmbyllet me hartimin e një raporti paraprak që i dërgohet drejtuesit /Administratorit të institucionit. Sipas dokumentacionit financiar në dispozicion (pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2023) pozicioni financiar dhe veprimtaria financiare e institucionit i nënshtrohen edhe auditimit të jashtëm vjetor nga kompania “Grant Thornton” shpk. Raportet e auditimit të jashtëm depozitohen në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me kërkesat e legjislacionit Shqiptar. Veprimtaria financiare e KUB i nënshtrohet edhe kontrolleve nga organet tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Komisi

[Signature]

	<i>(Evidenca 2. 72 Raport Auditimi dhe Pasqyra Financiare).</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ ka konstatuar se pasqyrat financiare të hartuara nga IAL janë të qarta, të strukturuar për përdoruesit e jashtëm dhe garantojnë besueshmëri, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet themelore të raportimit financiar si: besnikëria, përmbajtja ekonomiko-ligjore, paanshmëria, plotësia, si dhe sigurimi i një pamjeje të vërtetë dhe të saktë të pozicionit financiar të institucionit. Gjithashtu, në hartimin e tyre respektohen parimet e qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Çdo vit, treguesit financiarë dhe realizimi i buxhetit i nënshtrohen një analize nga Bordi i Administrimit dhe i raportohen njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit, në funksion të monitorimit të zbatimit të buxhetit të miratuar për vitin paraardhës. <i>(Evidenca 2. 63 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit);</i> <i>(Evidenca 2. 70 Projekt - Buxheti);</i> <i>(Evidenca 2. 72 Raport Auditimi dhe Pasqyra Financiare).</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar në legjislacionin në fuqi, IAL menaxhon burimet dhe kapacitetet e tij financiare për të mundur funksionimin normal të aktivitetit të tij. Me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë financiare, IAL ka ngritur struktura që planifikojnë dhe mbikqyrin veprimtarinë financiare të institucionit, si dhe përdorimin e burimeve dhe aseteve të tij. Ndër to, Bordi i Administrimit si organi më i lartë kolegjal administrativ ka si pjesë të kompetencave të tij edhe mbarëvajtjen financiare dhe administrative të institucionit. Nëse do të referohemi të dhënat e bilanceve 2020, 2021, dhe 2022 vihet re një rritje, në çdo vit, e të ardhurave që vijnë jo nga tarifat e shkollimit, por që janë të siguruar nga veprimtari të tjera të shfrytëzimit (nga 18.7 milion, 26.3 milion, në 28.2 milion lekë). Por, referuar Pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve të parashikuara për vitin akademik 2023-2024, këto të ardhura të siguruar nga aktivitete të tjera dhe jo nga tarifatat e shkollimit, bien ndjeshëm (në 13.2 milion lekë). <u><i>Rekomandohet që IAL të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të rritur të ardhurat dytësore, që mund të vijnë nga projektet</i></u>

Konural

[Signature]

	<i>kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nga shërbimet ndaj të tretëve.</i> <i>(Evidenca 2. 63 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit)</i> <i>(Evidenca 2. 69 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vjetet e fundit (Tabela 18);</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në të dhënat dokumentare GVJ konstaton se IAL garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit PICD "MSH në Drejtësi" dhe mbështetjen e studentëve.</i> <i><u>Rekomandohet</u> që IAL të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të rritur nivelin e të ardhurave dytësore që mund të vijnë nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nga shërbimet ndaj të tretëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të	IAL bazuar në aktet e brendshme rregullatore ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik, që nga pranimi i studentëve deri në daljen e tyre. Kështu në përputhje me Statutin e IAL-së (neni 55 e vijues),

Konkluzione

[Signature]

studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Rregulloren e UniBA, kreu VI, si dhe në rregulloren e Programit të Studimit, kreu V, zbatohen procedurat e pranimit të studentëve. Numri i studentëve si dhe shpërndarja e tyre bëhet sipas zërave në tabelën e percaktimit të kuotave të pranimit. Po kështu transferimi i studimeve, apo studimet në program të dytë studimi është rregulluar me Rregullore të veçantë. Diplomimi i studentëve bëhet në përputhje me Rregulloren e IAL-së dhe Rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu aktet e brendshme kanë një sërë parashikimesh mbi ciklin e studimeve, kohëzgjatjen e tyre, organizimin e procesit mësimor, kontrollin e dijeve, diplomimin etj. <i>(Evidenca 1.02, Rregullore e Universitetit Barleti, Kreu V);</i> <i>(Evidenca 1.01 Statuti);</i> <i>(Evidenca 3.01 Rregullore e Programit të Studimit);</i> <i>(Evidenca 1.13 Rregullore për transferimet dhe regjistrimet në programet e dyta)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ ka konstatuar se IAL respekton plotësisht kriteret dhe procedurat ligjore dhe nënligjore në të gjitha hallkat e procesit nga pranimi deri në përfundimin e studimeve. Këto procedura janë të qarta, transparente dhe sigurojnë trajtim të barabartë dhe respektim të të drejtave për të gjithë kandidatët për studentë, si dhe për studentët e programit të studimit. <i>(Evidenca 1.02, Rregullore e Universitetit Barleti, Kreu V);</i> <i>(Evidenca 1.01 Statuti);</i> <i>(Evidenca 3.01 Rregullore e Programit të Studimit)</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ ka konstatuar se Universiteti Barleti harton dhe publikon çdo vit, përpara fillimit të vitit akademik, kriteret të posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve që kërkojnë të pranohen në programet e studimit. Institucioni vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet përkatëse, duke bashkëpunuar ngushtë me strukturat përgjegjëse të maturës shtetërore (QSHA). Kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi konsiderojnë edhe parashikimet për kriteret e përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin për arsimin e lartë. Këto kriteret mundësojnë barazi në konkurrim dhe përzgjedhje objektive, bazuar në meritë.

Komiteti

	Referuar Evidencës 2.71 “Kriteret e përgjithshme dhe të veçantë të pranimit në programin e studimit”, gjejmë vetëm këtë parashikim sa i përket kriterëve të rekrutimit në programin PIND “MSH në Drejtësi”: “1. Kriteri i pranimit për aplikim në programin e integruar të ciklit të dytë Drejtësi është nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, per vitin akademik 2023-2024. 2. Renditja e aplikantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare bëhet sipas nivelit më të lartë të notës mesatare të përcaktuar ne VKM; Nëse nota do të rezultojë e njëjtë për më shumë se 2 aplikantë, do të merret nota më e lartë e provimit të Matematikës në Provimet e detyrueshme të Maturës; Nëse nota do të jetë, sërish e njëjte, merret në konsideratë koha e regjistrimit të aplikantit për të vazhduar studimer ne UniBa”.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Pranimi i studentëve në këtë program studimi bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me VKM dhe udhëzimet përkatëse të MAS të përditësuara për çdo vit akademik. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe të kuptueshme nga publiku. Të gjitha aktet rregullatore që i parashikojnë sa më sipër janë publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë këto informacione edhe në faqen zyrtare të të Universitetit (https://umb.edu.al/pranimet.html). UniBa ka funksionale dhe Zyrën e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit (ZRPR), e cila është njësi administrative që planifikon, menaxhon dhe koordinon procesin e rekrutimit, aplikimit, pranimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe udhëzimet institucionale https://umb.edu.al/zyra-e-rekrutimit-pranimet-dhe-regjistrimit.html . (Evidenca 1.14 Manual Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim i studentëve); (Evidenca 1.13 Rregullore për transferimet dhe regjistrimet në programet e dyta).
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik,	Kriteret e pranimit për çdo program studimi propozohen nga departamentet përkatëse dhe miratohen me vendim të Senatit

Konur

11/11

institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Akademik. Kriteret e përcaktuara për regjistrimin në këtë program studimi janë kritere të hartuara në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Kriteri bazë për këtë program studimi është përfundimi i maturës shtetërore dhe niveli i notës mesatare. Kriteret e veçanta mund të përcaktohen gjithashtu çdo vit akademik. Këto kritere së bashku me kuotat për çdo program studimi, dërgohen në MAS dhe bëhen publike për të interesuarit përpara fillimit të vitit akademik. Burimet e informimit që institucioni vë në dispozicion janë të tilla që mundësojnë informimin e gjerë të publikut dhe gjithë të interesuarve. Një burim i rëndësishëm i informimit është faqja zyrtare e institucionit, në seksionin “Pranimet”, ku përveç të tjerash, gjendet informacion edhe mbi kriteret e pranimet dhe tarifat e studimit për çdo program studimi. https://umb.edu.al/pranimet.html http://umb.edu.al/transferohu.html https://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UniBA nuk e kufizon mundësinë e pranimet në programet e studimit të kategorive të veçanta, përfshirë edhe kandidatë me aftësi të veçanta, pakica dhe shtresa të marginalizuara. Por, në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk rezulton që IAL të ketë miratuar kuota të veçanta për këto kategori studentësh. Gjithashtu, referuar Evidencës 2.71 “Kriteret e përgjithshme dhe të veçantë të pranimet në programin e studimit”, IAL nuk miraton kritere të veçantë të rekrutimit në programin e studimit PIND “MSH në Drejtësi” për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Për këtë kategori studentësh, IAL nuk përcakton kritere shtesë përveç atyre të sanksionuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>Sugjerim që IAL të miratojë kuota pranimi për këtë kategori studentësh, në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore përkatëse.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UniBA nuk e kufizon mundësinë e pranimet në programet e studimit të kandidatëve nga shtetet e tjera (psh. nga trojet Shqiptare, jashtë kufijve të RSH). Por, në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk rezulton që IAL të ketë miratuar kuota të veçanta për këto kategori studentësh nga shtete të tjera.

	Gjithashtu, referuar Evidencës 2.71 “Kriteret e përgjithshme dhe të veçantë të pranimit në programin e studimit”, IAL nuk miraton kriteret të veçantë të rekrutimit në programin e studimit PIND “MSH në Drejtësi” për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Për këtë kategori studentësh, IAL nuk përcakton kriteret shtesë përveç atyre të sanksionuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>Sugjerojmë që IAL të miratojë kuota pranimi për këtë kategori studentësh, në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore përkatëse.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Referuar dokumentacionit rezulton se IAL ofron 3 lloje bursash: “Bursat e vazhdimësisë”, për studentët që kanë ruajtur një mesatare të mirë gjatë viteve të studimit; “Bursat e talentit”, që jepen për studentët me rezultate të shkëlqyera në fusha të ndryshme; “Bursat për maturantët”, që u jepen maturantëve nëpërmjet konkurseve të ndryshme. Neni 84 i Rregullorës së IAL, bën këtë parashikim për politikën që UniBa bën në lidhje me bursat: “Universiteti Barleti ofron bursa të ndryshme studimi, të plota ose të pjesshme, bazuar në kriteret të përcaktuara në aktet e brendshme normative dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Institucioni bën transparencë të plotë mbi llojet e bursave të ofruara, përmes publikimeve zyrtare. Në zbatim të akteve të brendshme, nën drejtimin e Administratorit, IAL ngre komisione ad hoc për shqyrtimin e aplikimeve për bursa, ndërsa miratimi përfundimtar i përfutuesve realizohet nga Bordi i Administrimit”. Informacioni mbi bursa është publike dhe në faqën zyrtare të IAL-së: https://umb.edu.al/tarifa-dhe-bursa.html <i>(Evidenca 2.71 “Kriteret e përgjithshme dhe të veçantë të pranimit në programin e studimit; Llojet e bursave”)</i> <i>(Evidenca 1.02, Rregullore e Universitetit Barleti, Neni 84).</i>
Konkluzione	Universiteti “Barleti” harton, ndjek dhe zbaton politika të mira dhe procedura të qarta për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Armen

1/9

	<i>Kjo politikë është sanksionuar në akte ligjore dhe akte rregullatore të brendshme.</i> <i>Sugjerojmë që IAL të miratojë kuota pranimi për kategori të veçanta studentësh, përfshirë kandidatë me aftësi të veçanta, pakica dhe shtresa të marginalizuara, si dhe kandidatë nga shtete të tjera, në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informacion i plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjendet në parashikimet e akteve të brendshme rregullatore të IAL-së. Specifikisht në Rregulloren e programit PIND “Master i Shkencave” në “Drejtësi” janë parashikuar rregulla për frekuentimin e leksioneve dhe seminareve, vlerësimin e studentëve, kushtet për kalimin në vitin pasardhës, etj. Nëpërmjet publikimit të akteve rregullatore në faqen zyrtare zyrtare të KUB, këto procedura bëhen të njohura dhe lehtësisht të kuptueshme për studentët. Po kështu disa struktura si Sekretaria Mësimore dhe Kordinatori i Departamentit, luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve gjatë gjithë ecursisë së vitit akademik. Procesi i informimit është efikas dhe lehtësisht i aksesueshëm edhe nëpërmjet përdorimit të platformës “portali studentor”, ku studentët aksesojnë të gjithë informacionin e nevojshme nga Sekretaria Mësimore ose pedagogët e lëndëve (https://portal.umb.al/student/login) (Evidenca 3.01 Rregullore e Programit të Studimit, Kreu II, III).

Konur

Al G

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Gjatë javës së parë të vitit akademik, studentët vitit I kanë javën e akomodimit, ku studentët informohen studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Procedura e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimit është e parashikuar në aktet rregullatore të institucionit, veçanërisht në Rregulloren e Transferimeve, <i>(Evidenca 1.13 Rregullore për transferimet dhe regjistrimet në programet e dyta);</i> <i>(Evidenca 1.14 Manual Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim i studentëve);</i> <i>(Evidenca 3. 01, Rregullore e Programit të Studimit, Neni 14).</i>																
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Që gjatë javës së parë të vitit akademik, kur studentët vitit I kanë javën e akomodimit, studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive në programin PIND “MSH” në “Drejtësi”. Procedurat, kriteret e vlerësimit të dijeve si dhe mënyrat e komunikimit të rezultateve, janë të parashikuara në aktet rregullatore përkatëse. Kështu, psh në rregulloren e Programit të Studimit, në Kreun III, nenet 17-21 i rregullojnë aspektet e mësipërme. Vlerësimi i studentëve në një lëndë bazohet në vlerësimin e vazhduar (frekuentimi 10%; detyrimet/detyrat e kursit 10%; testimet gjatë vitit 10%); dhe vlerësimin përfundimtar të lëndës (provimi i lëndës 50%). Po kështu, edhe syllabusi i çdo lënde, i cili u komunikohet studentëve që në orën e parë të mësimi, parashikon mënyrën e vlerësimit të lëndës. Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim ose me gojë, bëhet me pikë nga 0-100 pikë, dhe rezultati përfundimtar konvertohet me notë nga (katër) në 10 (dhjetë) sipas tabelës së mëposhtme: <table data-bbox="608 1608 751 1843"> <tr> <th>Pikët</th><th>Nota</th></tr> <tr> <td>1-49</td><td>4</td></tr> <tr> <td>50-55</td><td>5</td></tr> <tr> <td>56-65</td><td>6</td></tr> <tr> <td>66-75</td><td>7</td></tr> <tr> <td>76-85</td><td>8</td></tr> <tr> <td>86-95</td><td>9</td></tr> <tr> <td>96-100</td><td>10</td></tr> </table> <i>Evidenca 3.01 Rregullore e Programit, kreun III;</i>	Pikët	Nota	1-49	4	50-55	5	56-65	6	66-75	7	76-85	8	86-95	9	96-100	10
Pikët	Nota																
1-49	4																
50-55	5																
56-65	6																
66-75	7																
76-85	8																
86-95	9																
96-100	10																

Handwritten signature

Handwritten signature

	<i>Evidenca 2.50 Format e kontrollit të njohurive, Tabela 15; Evidenca 3.08 Syllabuset;</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në programin e studimit PIND “MSH në Drejtësi”, ende nuk ka patur studentë të diplomuar, prandaj vlerësimi për këtë rubrikë bëhet bazuar në dokumentacion dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në IAL. Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës me punim (temë diplome) parashikohen në Rregulloren e programit të studimit, kreu IV. Gjithashtu, GVJ ka konstatuar se njesia përgjegjëse e programit informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit PIND “MSH në Drejtësi”, nëpërmjet vënies në dispozicion të një dokumenti përmbledhës “Paketa e Provës Finale”. Në këtë dokument janë të parashikuara të gjithë procedurat e përgjedhjes, miratimit, shkrimit të temës së diplomës (formati), prezantimit të saj, përgjegjësitë e studentit diplomant dhe udhëheqësit të temës, përgjegjësitë e komisionit të mbrojtjes, si dhe mënyra e vlerësimit të punimit. <i>(Evidenca 2. 20 Paketa e Provës Finale).</i> <i>(Evidenca 3.01 Rregullore e Programit, kreu III).</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Nëpërmjet një sërë formash të shpërndarjes së informacionit, IAL-ja informon studentët mbi programet e studimit që ofron, si dhe kapacitetet akademike dhe infrastrukturore në funksion të realizimit të programeve të studimit. Informacioni jepet mbi programet dhe format e studimit, kriteret dhe procedurat e pranimit, tarifat e studimit, infrastrukturën, shërbimet dhe facilitetet, personelin akademik përgjegjës etj. IAL përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike publikon udhëzues të posaçëm, si dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Kryesisht këto takime informuese realizohen në shkollat e mesme. Gjithashtu prezantime në detaje për kriteret e pranimit në secilin program studimi, tarifat, bursat, etj, paraqiten dhe në ëbsite të IAL: https://umb.edu.al/pranimet.html. Në funksion të këtij informimi shërben edhe <i>Agjenda e Ditëve të Akomodimit</i>, që është realizuar në fillim të vitit akademik, datë 07-08 Tetor.

Procurator

ND

	(Evidenca 2. 73 Agjenda e Ditëve të Akomodimit).			
Konkluzione	IAL vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit PICD "MSH në Drejtësi" informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Duke përdorur burime të ndryshme të informacionit, IAL mundëson informimin e studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Aktet regullatore të institucionit janë një burim i rëndësishëm informimi. Bazuar në rregulloren e programit të studimit, nenet 2, 3, 4, Programi i studimit PIND "Master i Shkencave në "Drejtësi", zhvillohet me 300 kredite (ECTS), në përputhje me planin mësimor. Kohëzgjatja normale e këtij programi është pesë vite akademike ose dhjetë semestra. Rregullorja e këtij programi studimi ka gjithashtu rregullime mbi ngarkesën, kohëzgjatjen dhe kreditet e lëndëve. Një burim tjetër informues është plani mësimor i programit të studimit, i cili përcakton të gjithë komponentët e nevojshëm si: lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje, kreditet për secilën lëndë, si dhe semestrin e zhvillimit të tyre. Plani gjendet i publikuar edhe në faqen zyrtare të IAL-së: https://umb.edu.al/upload/studime/MSK-Plani-mesimor-drejttesi-upsh-24.pdf IAL ka përpiluar për këtë qëllim edhe fletëpalosje, broshura, postera, si dhe materiale audio-vizive, të cilët gjenden dhe online në faqen zyrtare të UniBa. https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/VOLANT-msc-drejttesi-upt-21.pdf.

	https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/UNIBA-BROCHURE-2024-SQ.pdf Informacioni i detajuar për programin PIND “MSH në Drejtësi” gjendet gjithashtu në faqen zyrtare të universitetit: https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-drejttesi-program-i-integruar.html <i>(Evidenca 3.01 Rregullore e Programit)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	IAL vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion udhëzues për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese përmes koordinatorit të departamentit, i cili merr masat përkatëse për mbarëvajtjen e këtij procesi. Në fillim të çdo semestri, pedagogët e lëndëve shpërndajnë syllabus-in, i cili përmban temat për çdo javë mësimore, literaturën përkatëse dhe format e vlerësimit. Një shpjegim i plote mbi programin e veprimtarirë formuese jepet në Udhëzuesin Didaktik “Program i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave në Dejtësi”. Informacioni i detajuar për programin e studimit PIND “MSH në Drejtësi” gjendet gjithashtu në faqen zyrtare të universitetit: https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-drejttesi-program-i-integruar.html <i>(Evidenca 2. 57 Udhëzues didaktik).</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Referuar Rregullores së Funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve, rezulton se UniBA i kushton një vëmendje të veçantë studentëve duke i konsideruar si një nga shtyllat kryesore ku bazohet veprimtaria institucionale. Për këtë arsye pranë UniBA funksionojnë këto zyra: - Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit; - Zyra e Dekanit të Studentve; - Zyra e Alumni dhe Karrierës; - Njësi mbështetëse; GVJ ka konstatuar se Zyra e Alumni dhe Karrierës informon dhe mbështet studentët lidhur me mundësitë e punësimit dhe orientimin profesional drejt tregut të punës. Në detyrat e Zyrës së Alumni dhe Karrierës përfshihet dhe organizimi i takimeve këshilluese të karrierës, organizimi i panairove të punës, shpallja e ofertave të punës, organizimi i vizitave në kompani të ndryshme me synim trajnimin dhe

Bonus

[Signature]

	punësimin (neni 11 i Rregullores së Funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve). Nga vizita e kryer dhe dokumentacioni në dispozicion, GVJ konstaton se përgjithësisht kjo zyrë i ka përmbushur detyrat e saj. https://students.umb.edu.al/news5768.html. https://students.umb.edu.al/news5650.html; https://students.umb.edu.al/news5774.html. <i>(Evidenca 1. 16 Rregullores së Funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve)</i> <i>(Evidenca 2. 76 Të dhëna nga zyra e karrierës për informimin e studentëve)</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Plani mësimor dhe kalendari i veprimtarive akademike janë dokumenta që u vihen në dispozicion studentëve, nga zyrat në shërbim të studentëve, por që gjenden edhe on line në faqen zyrtare të IAL-së. Në këtë mënyrë studentët informohen mbi zhvillimin e procesit mësimor. Në fillim të çdo semestri, studentët njihen me syllabus-et e lëndëve që përmbajnë temat, literaturën bazë dhe të rekomanduar, format e vlerësimit dhe formën e kontrollit të dijeve. Informacion në lidhje me organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij gjendet dhe në fletë-palosjet dhe posterat e ndryshëm që u vihen në dispozicion studentëve dhe që publikohen edhe on line, në faqen zyrtare të UniBa. https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/VOLANT-msc-drejtisi-upt-21.pdf. https://umb.edu.al/upload/studiesbroshures/UNIBA-BROCHURE-2024-SQ.pdf Informacion shtesë mbi kalendarin akademik dhe veprimtaritë e tjera, si dhe mbi orarin, u shpërndahet në mënyrë të strukturuar nga organet përkatëse. https://studentportal.umb.edu.al/. <i>(Evidenca 3.02 Kalendari akademik 2024-2025).</i> <i>(Evidenca 3. 06 Orari mësimor);</i> <i>(Evidenca 2. 48 Kalendari i konsultimeve).</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të	Nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, sigurohet informacion i plotë mbi programin e studimi, kalendarin e veprimtarive akademike, orarin dhe çdo

Korunsi

[Signature]

brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	informacion tjetër. Ky informacion është i disponueshëm për studentët dhe për gjithë publikun përmes faqes zyrtare: - https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-drejttesi-program-i-integruar.html; - https://umb.edu.al/upload/studime/MSC-Plani-mesimor-drejttesi-upsh-24.pdf - https://umb.edu.al/kalendari-akademik.html Nëpërmjet faqes zyrtare dhe portalit studentor, (https://studentportal.umb.edu.al/), studentët, pavarësisht distancës apo vendndodhjes, kanë akses të plotë në rezultatet e provimeve dhe në çdo informacion tjetër akademik. <i>(Evidenca 1.26 Udhëzues për përdorimin e strukturës së TIK).</i>			
Konkluzione	<i>IAL ka ngritur struktura për ndekjen dhe përparimin e karrierës së studentëve, të cilat i orientojnë studentët në lidhje me tregun e punës dhe mundësitë e punësimit.</i> <i>Gjithashtu ata vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Programi i studimit është duke përmbushur vitin e V dhe duke qenë program i integruar 5-vjeçar, ende nuk ka student të diplomuar. IAL disponon të dhëna të sakta mbi numrin e studentëve të regjistruar në çdo vit akademik në këtë program studimi. <i>(Evidenca 2. 77 Të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve (Tabela 21 dhe tabela 23).</i>

[Signature]

[Signature]

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ ka konstatuar se IAL disponon një bazë të dhënash të detajuar që përfshin studentët e regjistruar në programin e studimit, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë përkohësisht studimet si dhe ata që janë çregjistruar. Këto të dhëna ruhen dhe menaxhohen nga Sekretaria Mësimore. Mbështetur në të dhënat e marra gjatë vizitës në sekretartinë mësimore, rezulton se numri i studentëve të regjistruar në pesë vite akademike për këtë program është: viti akademik 2020 – 2021 12 studentë; viti akademik 2021 – 2022 13 studentë; viti akademik 2022 – 2023 14 studentë; viti akademik 2023 – 2024 34 studentë; viti akademik 2024 – 2025 40 studentë;
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit, IAL menaxhon të dhënat e studentëve, të cilat janë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Në përputhje me kompetencat, administrimi i dokumentacionit dhe përpunimi i të dhënave të studentëve bëhet nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të IAL. Ky sistem i menaxhimit të informacionit mundëson marrjen e të dhënave si dhe raportimin në kohë reale tek autoritetet drejtuese. Këto të dhëna, më tej pëpunohen për të evidentuar statistika mbi aspekte të ndryshme të ciklit akademik. Institucioni i përfshin të dhënat statistikore në raportet e hartuara në nivel instiucional ose njësie kryesore. <i>(Evidenca 1.11 Rregullore për funksionimin e Sekretarisë Mësimore).</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që	Referuar akteve rregullatore të IAL-së, autoritete drejtuese kanë të drejtën e kontrollit dhe verifikimit të dosjeve dhe të dhënave që krijohen dhe administrohen nga Sekretaria Mësimore. Ruajtja e një pjese të këtij informacioni bëhet në format elektronik dhe akses në verifikimin e tij kanë autoritetet përkatëse. Portali studentor (https://studentportal.umb.edu.al/) dhe Portali i stafit (https://portal.umb.al/admin/login) i krijon akses gjithashtu studentëve dhe stafit akademik në të dhënat e tyre akademike.

Krasni

[Signature]

lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	(Evidenca 1.11 Rregullore për funksionimin e Sekretarisë Mësimore).			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se Departamenti i Drejtësisë së UniBa, bazuar në të dhënat që administron mbi studentët, përfshirë të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje, përgatit çdo vit akademik një raport analitik. Statistikat mbi të dhënat e studentëve janë pasqyruar edhe në raportet vjetore mbi veprimtarinë akademike dhe financiare që hartohen në nivel institucional. Përfshirja e të dhënave statistikore në raportet vjetore ndihmon në analizat mbi performancën dhe cilësinë e programeve të studimit si dhe hartimit të masave për përmirësimin e treguesve të cilësisë. Duke qënë së programi Masteri Shkencave (PIND) në “Drejtësi” nuk ka studentë të diplomuar, ende nuk ka të dhëna mbi punësimin e studentëve në këtë program studimi. (Evidenca 2. 07 Raporti vjetor Departamentit të Drejtësisë); (Evidenca 2. 77 Të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve (Tabela 21 dhe tabela 23).			
Konkluzione	GVJ ka konstatuar se IAL nëpërmjet strukturave të saj ligjore, mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin dhe cilësinë e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim. Administrimi i të dhënave mundësohet nëpërmjet një sistemi të menaxhimit të informacionit i cili mundëson marrjen e të dhënave si dhe raportimin në kohë reale tek autoritetet drejtuese. Këto të dhëna bëhen pjesë e raporteve të vlerësimit të performacës akademike dhe administrative të IAL-së.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Bourti!

[Signature]

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Konstatohet se IAL mundëson kontributin e studentëve në proceset e rëndësishme vendimmarrëse që lidhen me veprimtarinë akademike dhe garantimin e standarteve të cilësisë së institucionit. Përfshirja e studentëve mundësohet nëpërmjet përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse më të rëndësishme në nivel institucional. Statuti i Universitetit “Barleti” sanksionon përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Studentët marrin pjesë në Senatin Akademik, në komisionet e përhershme, si edhe në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për hartimin e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm. Gjithashtu aktet e brendshme rregullojnë procedurat e zgjedhjes së Qeverinë Studentore të Universitetit Barleti. <i>(Evidenca 1.01, Statuti i IAL-së, Neni 20, 23).</i> <i>(Evidenca 2.04 Urdhër nr.59, datë 18.12.2024 “Për ngritjen e GVB”).</i> <i>(Evidenca 1.24 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve në Qeverinë Studentore të UniBa).</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët janë anëtarë të disa prej strukturave më të rëndësishme drejtuese në KUB si: Senati Akademik, NJSBC, GVB-të, etj, në të cilat kontributi i tyre është i drejtpërdrejtë si anëtarë me të drejta të plota të këtyre strukturave. Në këto struktura ata japin mendime dhe opinione që konsiderohen nga këto organe. Përfshirja e studentëve është shumë e rëndësishme edhe në procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, nëpërmjet sondazheve, që realizohen dy herë në vit nga Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë dhe që vlerësojnë secilën lëndë dhe pedagog. Opinioni dhe mendimet e studentëve efektojnë dhe hartimin e raporteve ku ata marrin pjesë si anëtarë të grupit të punës. <i>(Evidenca 1.28 Pyetësori i Studentëve).</i> <i>(Evidenca 2.82.1 Raportimi i vlerësimit të studentëve V.A 2023-2024, Sem.I, SemII);</i>

K. Sami

17/11

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Aktet e brendshme rregullatore përcaktojnë detyrimin që Njësia përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë të përfshijë studentët në vlerësimin e performacës akademike të institucionit. Kështu, neni 5 i Rregullores së Nj.Zh.K.C, parashikon që Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë organizon në fund të çdo semestri (dy javë para përfundimit) pyetësorin me studentet për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Gjithashtu kjo strukturë organizon fokus grupe me studentët në nivel fakulteti për të kuptuar në thellësi vlerat dhe sfidat e procesit mësimor sipas perspektivës së studentëve. Në këtë mënyrë, studentët kontribuojnë me opinionin e tyre në vlerësimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Nga intervista e kryer nga GVJ, autoritetet drejtuese dhe përfaqësuesit e Nj.Zh.K.C deklaruan se përfundimet e anketimeve dhe fokus-grupeve analizohen nga njësia bazë. Megjithatë duhet evidentuar se nga dokumentacioni nuk u konstatua ndonje raportim apo formë tjetër reflektimi ku të ishin evidentuar konkluzioni i opinionit të studenteve (i nxjerrë nga anketimi) dhe rekomandimet apo detyrat konkrete për njësinë bazë apo pedagogët për të rishikuar përmbajtjen e lëndëve apo/dhe për të përmirësuar procesin mësimor. Gjykojmë se, në përfundim të raportimeve përmbledhëse të anketimeve për IAL-në, duhet të hartohen Memo apo Raporte të detajuar specifikisht për Departamentin e së Drejtës, që të përmbajnë konkluzionin e opinionit të studenteve specifikisht për lëndët e programit të studimit PIND “MSH në Drejtësi”, ku mundësisht të evidentohen dhe rekomandimet e titullarëve për masat që duhen marrë për të përmirësuar eventualisht elementë specifikë të procesit mësimor. <i>(Evidenca 1.28 Pyetësori i Studentëve)</i> <i>(Evidenca 1.06 Raporti vjetor i monitorimit dhe sigurimit të cilësisë);</i> <i>(Evidenca 1.07 Rregullore e Nj.Zh.K.C)</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së	Procedurat dhe kriteret e vlerësimit të studentëve për çdo lëndë, janë përcaktuar në rregulloret e IAL-së, si dhe në syllabus-in e secilës lëndë. Të njëjtat akte rregullatore parashikojnë të drejtën e studentëve për të ankimuar si procedurën e zhvillimit të

Procedurë

[Signature]

procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	provimit ashtu edhe vlerësimet që pedagogët kanë bërë në sejcilën lëndë (neni 89 dhe 90 i Rregullorës së UniBa). Pedagogët janë të detyruar të zhvillojnë seanca sqaruese me studentët për të dhënë vlerësimet e provimeve. Studentët kanë mundësi të japin opinionin e tyre mbi procesin e vlerësimit të lëndës nga pedagogët edhe gjatë anketimeve periodike që ata bëjnë, 2 herë në vit, ku ata mund të shprehin opionionin edhe mbi këtë komponent.			
	(Evidenca 1. 02, Rregullore e UNIBA, Neni 88 - 90); (Evidenca 3. 01, Rregullore e Programit të Studimit, Neni 28 “Te drejtat e studenteve, pika 8)			
Konkluzione	GVJ ka konstatuar se IAL përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjithashtu ata japin mendimin e tyre, nëpërmjet anketimeve periodike që zhvillon struktura përkatëse, edhe në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Gjykojmë se, në përfundim të raportimeve përmbledhëse të anketimeve për IAL-në, duhet të hartohen Memo apo Raporte të detajuar specifikisht për Departamentin e së Drejtësisë, që të përmbajnë konkluzionin e opinionit të studenteve specifikisht për lëndët e programit të studimit PIND “MSH në Drejtësi”, ku mundësisht të evidentohen dhe rekomandimet e titullarëve për masat që duhen marrë për të përmirësuar eventualisht elementë specifikë të procesit mësimor. IAL ka krijuar mekanizma efektivë që studentët të kenë mundësi të shprehin mendimin e tyre edhe mbi procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Konkluzioni

Ally

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Referuar Rregullores së Funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve, rezulton se UniBA i kushton një vemendje të veçantë studentëve duke i konsideruar si një nga shtyllat kryesore ku bazohet veprimtaria institucionale. Për këtë arsye pranë UniBA funksionojnë këto zyra: - Zyra e Rekrutimit, Pranimi dhe Regjistrimit; - Zyra e Dekanit të Studentëve; - Zyra e Alumni dhe Karrierës; - Njësi mbështetëse; Gjithashtu në funksion të informimit dhe në shërbim të studentëve janë edhe Sekretaria Mësimore, si dhe Koordinator i Departamentit. <i>(Evidenca 1.16 Rregullore e Funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve).</i> <i>(Evidenca 2.76 Të dhëna nga zyra e karrierës për informimin e studentëve)</i> <i>(Evidenca 1.11 Rregullore për funksionimin e Sekretarisë Mësimore)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Nga intervistat që GVJ ka zhvilluar me studentët, por dhe nga rregullimi normativ që ofrojnë aktet e brendshme të IAL-së, rezulton se në UniBA funksionon një sistem informimi, këshillimi, asistimi dhe ndjekje për ecurinë e studentëve në këtë program studimi. Për shqetësimet që kanë, apo informacionet që studentët duan të marrin në lidhje me programin e studimit dhe procesin mësimor, ata mund t'i drejtohen të gjitha strukturave që janë ngritur dhe funksionojnë në IAL për mbështetjen e studentëve: Sekretaria Mësimore, Koordinator i Departamentit, Dekani i Studentëve dhe Zyra e Alumni dhe Karrierës. Gjithashtu mbështetje dhe informacion mund të kërkohet nga studentët edhe në funksion të jetës studentore, pjesëmarrjes në aktivitete dhe shërbimeve mbështetëse, brenda dhe jashtë IAL-së.

Kouwe

[Signature]

	<i>(Evidenca 1.16 Rregullore e Funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve).</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga intervistat që GJV ka zhvilluar me studentët, nga rregullimi normativ që ofrojnë aktet e brendshme të IAL-së, por dhe nga informacioni në faqen zyrtare të UniBa, rezulton se njësia e këshillit të karrierës studentore është aktive, duke organizuar Panairë pune, Intervieë ëorkshop, Seanca trajnuese të këshillimit të karrierës, Këshllime për praktikën etj. https://umb.edu.al/news5858.html https://umb.edu.al/news5850.html https://umb.edu.al/news5813.html https://umb.edu.al/news5774.html <i>(Evidenca 1.16 Rregullore e Funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve).</i> <i>(Evidenca 2. 76 Të dhëna nga zyra e karrierës për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe aktivitete për orientimin drejt tregut të punës).</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sipas informacionit të faqes zyrtare, por dhe intervistës së zhvilluar, rezulton se Universiteti Barleti, mban një lidhje shumë të ngushtë me sipërmarrësit e diplomuar në Barlet. Zyra harton raporte dhe plane vjetore për gjurmimin e të diplomuarve dhe ua vë ato në dispozicion strukturave përkatëse. Çdo vit të ri akademik zyra “Alumni dhe Karriera”, organizon eventin “Alumni sipërmarrës i vitit”, duke vlerësuar kështu sipërmarrësit më të suksesshëm. Kjo Zyrë, në vijueshmëri të takimeve, aktiviteteve dhe organizimeve me studentët Alumni Barletas, shpall Ambasadorët Alumni. Pavarësisht se në këtë program studimi nuk ka të diplomuar, nisur nga eksperiencia me alumni të programeve të tjera të këtij universiteti, gjykohet se do të vazhdojë e njëjta praktikë kontaktimi, ndjekje dhe bërje pjese të akviteteve edhe me juristët e diplomuar nga programi 5-vjeçar PIND Drejtësi. https://umb.edu.al/news5884.html https://umb.edu.al/upload/pdf/Raporti-Alumni-te-dhenat-statistikore.pdf <i>(Evidenca 2. 34 Aktivitete me alumni ndër vite).</i>

Kruja

Alti

Konkluzione	GVJ ka konstatuar se IAL ka procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme dhe janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Gjurmimi i studentëve alumni në UniBa është tashmë një praktikë e konsoliduar që duhet të ruhet edhe për studentët e programit PIND "MSH në Drejtësi".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Siç u evidentua edhe nga takimi i GVJ me personelin akademik, në funksion të formimit të studentëve me njohuritë e nevojshme teoriko-praktike personeli akademik përdor metoda të mësimdhënies që aftësojnë studentët, jo vetëm me njohuritë teorike, por edhe ato praktike. Mësimdhënia nuk kufizohet vetëm tek marrja e informacionit dhe riprodhimi i tij. Kombinimi i leksioneve me praktikën gjyqësore, zgjidhja e kazuseve, zhvillimi i debateve, si dhe forma të tjera interaktive, nxisin aftësimin praktik dhe analitik të studentëve. Një dokument i rëndësishëm i hartuar në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, është Udhëzuesi për metodat e mësimdhënies

Konkluzi

[Signature]

	Një tjetër dokument i rëndësishëm Rregullorja e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Në UniBa zbatimi i metodave inovative të mësimdhënies, realizohet edhe nëpërmjet përdorimit të teknologjive inovative. U konstatua se klasat e leksioneve dhe seminareve janë të paisura me mjete e nevojshme si: Lab Top, video projektorë, kamera, tabela shkrimi si dhe akses të palimituar në internet. <i>(Evidenca 1.26 Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacioni)</i> <i>(Evidenca 1.25 Udhëzues në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies).</i> <i>(Evidenca 1.07 Rregullore e Nj.Zh.K.C),</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Pjesë e monitorimit të cilësisë në IAL është dhe monitorimi i aftësive të mësimdhënies. Në UNIBA është miratuar manuali i cilësisë Monitorimi, ku përcaktohet se mbikëqyrja dhe vlerësimi i mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmësakademik bëhet periodikisht nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. <i>(Evidenca 2.75 Manuali i cilësisë).</i> Sipas nenit 6 të Rregullores për vlerësimin dhe administrimin e performancë, struktura kompetente për vlerësimin e performacës së personelit akademik janë Departamentet, Komisioni i Vlerësimit të Performancës dhe Zyra e Menaxhimit dhe Adiministrimit të Performacës <i>(Evidenca 2. 81 Rregullore për vlerësimin dhe administrimin e performancës)</i> Zyra e Menaxhimit dhe Adiministrimit të Performacës për të vlerësuar aftësitë mësimdhënëse përdor ndër të tjera: Mbledhje dhe analizim të Raportimeve të Punës Semestrale; Formularë të Vlerësimit të Mësimdhënies Kolegë me Kolegë, apo dhe pyetësorë të studentëve. <i>(Evidenca 2. 79 Formular i Vlerësimit të Mësimdhënies Kolegë me Kolegë).</i> <i>(Evidenca 2. 15 Format i raportimit të punës semestrale);</i> <i>(Evidenca 1. 28 Pyetësori i studentëve)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e	Në mënyrë periodike para çdo sezoni provimesh mbledhen të dhëna mbi perceptime të studentëve lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien për programin e studimit. Në këtë mënyrë, por dhe nëpërmjet fokus grupeve, studentët përfshihen në

Bonus

metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	mënyrë aktive në vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të njohurive. (<i>Evidenca 1. 28 Pyetësori i studentëve</i>) Duke konsideruar dhe analizuar rezultatet e vlerësimeve të studentëve mbi përmbajtjen e lëndës, mënyrën e mësimdhënies, literaturën, si dhe vlerësimin e dijes, hartohet një raport për vlerësimet e studentëve. (<i>Evidenca 2. 82 Raport i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024</i>) Aktet rregullatore të brendshme u njohin studentëve edhe të drejtën e ankimimit, si për shkeljen e procedurës së zhvillimit të provimit brenda 24 orëve nga data e provimit, ashtu dhe për rezultatin përfundimtar të tij brenda 48 orëve nga marrja dijeni për rezultatin (<i>Evidenca 1. 02, Rregullore e UniBa, Neni 88 - 90</i>).
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në kuadrin e sigurimit të cilësisë, Nj.Zh.K.C përpunon të dhënat që vijnë nga anketimet dhe instrumentat e tjerë të vlerësimit të cilësisë dhe harton Raportin Vjetor, në nivel institucional. Sipas dokumentit të <i>Raporti vjetor i monitorimit dhe sigurimit të cilësisë</i>, vlerësohen fillimithst realizimi i objektivave të IAL-së, si dhe jepen rekomandime për përmirësimin e cilësisë. Raportet e vlerësimit të cilësisë dërgohen fillimisht në rektorat, dhe më tej bëhen të njohura edhe për fakultetet dhe departamentet. Më tej, raportet vjetore të vlerësimit të cilësisë bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. (<i>Evidenca 1. 06 Raporti vjetor i monitorimit dhe sigurimit të cilësisë VA 2023-2024</i>)
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ ka konstatuar se IAL promovon dhe nxit përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet rezultateve të vlerësimeve dhe mekanizmave stimuluese. Në bazë të Rregullores për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës (neni 12), periudha e vlerësimit të performancës së stafit akademik janë përcaktuar: A. Periudha 10-30 Shtator – Zyra Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Z.M.B.Nj.) verifikon përditësimin dhe dorëzimin e CV për të gjithë personelin. B. Periudha e fundit të dy semestrave akademikë (15-25 shkurt dhe 1-15 korrik) Personeli me kohë të plotë përcjell me e-mail Raportimin e Punës Semestrale në Z.M.B.NJ dhe ZMAP (Zyra e Menaxhimit dhe Administrimit të Performancës), me kërkesën e këtyre të

Handwritten signature

Handwritten signature

	fundit. (Evidenca 2.81 Rregullore e Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës). GVJ nuk konstatoi praktika të promovimit apo nxitjes së përmirësimit të mësimdhënies përpos asaj të <i>Pjesëmarrjes në programin Erasmus+</i> për shkëmbime akademike dhe projekte të përbashkëta me universitete partnere ndërkombëtare (Evidenca 2. 39 Informacion mbi grandet e përfituara në kuadër të projekteve Erasmus); (Evidenca 2. 40 Marrëveshje bashkëpunimi Erasmus). <u>GVJ rekomandon</u> qe institucioni të bëjë më shumë në këtë drejtim dhe forma të promovimit mund të jenë shpërblime financiare, apo mbulim i shpenzimeve për botim të artikujve apo pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare.			
Konkluzione	IAL ndjek një politikë të qartë dhe ka miratuar rregullime normative për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Gjithashtu janë ngritur mekanizma për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, duke përdorur instrumenta të ndryshme të monitorimit (psh pyetësorë të posaçëm), nëpërmjet të cilëve merret edhe mendimi i studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies. <u>GVJ rekomandon</u> qe institucioni të përdorë forma të promovimit apo nxitjes së përmirësimit të mësimdhënies, siç mund të jenë shpërblime financiare, apo mbulim i shpenzimeve për botim të artikujve apo pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika,	GVJ ka konstatuar se IAL ka miratuar politika dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këto politika

Prokuror

[Signature]

struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	janë fiksuar në aktet e brendshme rregullatore si Statuti, Rregullorja e institucionit, Strategjia e Njesisë për Zhvillim të Kurrikulës dhe Cilësisë (NJZhKC), Politikat e Garantimit të Standardeve të Cilësisë. <i>(Evidenca 1. 05 Strategjia e Nj.Zh.K.C 2024-2029) (Evidenca 1. 09 Politikat e ganatimit të starndarteve të cilësisë)</i> Politikat e sigurimit të cilësisë janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe për zbatimin e tyre dhe zbatohen nga dy struktura përgjegjëse kryesore për sigurimin e cilësisë, të cilat janë parashikuar në neni 14 dhe 15 të Rregullores së IAL-së: Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Rregullime për këto struktura gjejmë dhe në Statutin e IAL-së, neni 10, neni 28. Për ushtrimin e përgjegjësisë dhe kompetencave të këtyre dy strukturave, IAL ka miratuar edhe rregullore të posaçme: Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë dhe Rregulloren e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Në zbatim të nenit 7 dhe 8 të Rregullores së Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës, në nivel institucional është ngritur dhe funksionon edhe Komisioni i Vlerësimit të Performancës, i cili përbëhet nga përfaqësues që mbulojnë të gjitha shtyllat e veprimtarisë së institucionit: veprimtaria akademike, kërkimi shkencor, çështjet studentore, marrëdhëniet me komunitetin etj. Veprimtaria e këtij komisioni kordinohet nga Kordinatori i Menaxhimit të Performancës dhe konsiston në analizën e raporteve lidhur me performancën dhe realizimin e objektivave, si dhe raporteve lidhur me strukturat dhe individët, vlerësimin e performancës së personelit, etj. <i>(Evidenca 1.01 Statuti i IAL-së, neni 10, neni 28),</i> <i>(Evidenca 1. 02 Rregullore e UniBa, neni 14, neni 15).</i> <i>(Evidenca 1.08 Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë)</i> <i>(Evidenca 1.07 Rregullore e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë).</i> <i>(Evidenca 2. 81 Rregullore e Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës).</i>
---	---

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ ka konstatuar se përveç strukturave të posaçme për sigurimin e cilësisë, ekziston një bashkëpunim i gjerë ndërmjet një sërë njësisish të brendshme të IAL-s, të cilat kontribuojnë në zbatimin e Strategjisë institucionale dhe asaj të NJZhKC-së për sigurimin e cilësisë. Në kuadër të strategjisë së tij të re 2020-2030, për të përmbushur misionin dhe për të realizuar vizionin e tij, e zhvillon aktivitetin mbështetur në pesë shtylla kryesore: 1. Shtylla Akademike: fokusuar në veprimtaritë akademike me anë të kombinimit të shërbimeve arsimore, online me ato të drejtpërdrejta; 2. Shtylla e Studentit në Qendër: fokusuar në veprimtaritë studentore dhe komunitare; 3. Shtylla e Kërkimit të Aplikuar dhe Inovacionit: fokusuar në veprimtaritë kërkimore me karakter shkencor dhe të aplikuar, inovacionin dhe projektet në fusha të ndryshme si drejtësia, qeverisja, ekonomia, tregtia, industria, teknologjia, informatika, energjetika, shkencat mjekësore etj; 4. Shtylla Korporative dhe Administrative: fokusuar në veprimtaritë me karakter administrative; 5. Shtylla Sipërmarrëse: fokusuar në veprimtaritë e sipërmarrjeve të ngritura nga ana institucionit, me qëllim përmbushjen e misionit të tij. <i>(Evidenca 1.03 Plani strategjik i zhvillimit 2020-2030)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ ka konstatuar se, IAL ka zhvilluar një paketë të plotë instrumentesh për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, e cila përfshin: • Pyetësorë anonimë të vlerësimit të lëndëve nga studentët (<i>Evidenca 1.28</i>), të cilët analizohen për të hartuar raporte përkatëse cilësore; • Formularë për transparencën e vlerësimit (<i>Evidenca 2. 82</i>); • Formularë për vlerësimin “kolegu ndaj kolegut” (<i>Evidenca 2. 79</i>). Akreditimet e jashtme kanë qenë periodike, sipas planifikimit të bërë nga ASCAL. Akreditimi i fundit është zhvilluar në vitin 2021 dhe me vendim Nr.60, date 16.12.2021 të Bordit të

Prokuror

[Signature]

	Akreditimit të ASCAL, është disponuar për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë Universiteti "Barleti", për një periudhë 5-vjeçare. (Evidenca 2. 01 Vendimi i BA Nr.60/2021)
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ ka konstatuar se IAL ka vendosur një praktikë të rregullt të raportimit periodik (vetë-deklarimit) nga ana e stafit akademik me kohë të plotë. Format i vetëdeklarimit të stafit akademik përmban raportimin e punës semestrale të akademikut, ku pasqyrohen aspektet e angazhimit gjatë semestrit, si: • Mësimdhënia dhe Trajnime (A), • Punë Kërkimore-Shkencore (B), • Angazhimi Administrativ (Akademik, Korporativ, Qendra/Projekte), Angazhim në veprimtari të shtyllës studentore (C). (Evidenca 2. 15 Format i raportimit të punës semestrale) Kriteret e vlerësimit të performancës të stafit akademik dhe grupimi i tyre parashikohen në Rregulloren për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës, neni 13. (Evidenca 2. 81 Rregullore e Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës). Si e metë u konstatua se nuk rezultoi që nga IAL të jenë aplikuar mekanizma nxitës efektiv bazuar në këto tregues cilësorë, siç mund të jetë: promovimi në pozicione, apo mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kërkimore. Gjithashtu konstatohet se pjesëmarrja e studentëve dhe incentivimi i pjesëmarrjes së tyre në këto aktivitete kërkimore-shkencore nuk është në nvelin e duhur.
Konkluzione	<i>IAL harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave të brendshme të sigurimit të cilësisë, të ngritura me aktet rregullatore të IAL-së. Në këto akte janë përcaktuar kompetencat, detyrat dhe roli i strukturave të brendshme dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.</i> <i>Rekomandohet që nga IAL të ndërmerren veprime konkrete efektive promovuese për arritjet më të mira në programin e studimit siç mund të jetë: promovimi në pozicione, apo mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kërkimore. IAL duhet të marrë masa që të promovojë</i>

Homoni

Mly

	<i>dhe incentivojë pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete të kërkimit shkencor, si konferenca apo botime shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	IAL ka vënë në zbatim mekanizmat e duhur për mbikëqyrjen periodike të këtij programi studimi si dhe përdor struktura dhe procedura për vlerësimin e cilësisë së programit të integruar të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Drejtësi”. Bazuar në nenin 6 të <i>Rregullores së Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës</i>, strukturat kompetente për vlerësimin e performancës së programit të studimit janë: Departamentet; Komisioni i Vlerësimit të Performancës (KVP); Zyra e Menaxhimit dhe Administrimit të Performancës; Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Këto struktura përdorin mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit, si psh Raporti i vlerësimit të studentëve (<i>Evidenca 2.82</i>). Po ashtu, Departamenti i Drejtësisë, përgjegjës për programin, përfshin vlerësime të brendshme të programit të studimit, në raportet e tij vjetore. (<i>Evidenca 2. 07 Raporti vjetor i departamentit të Drejtësisë</i>) Të gjitha rezultatet formalizohen në raporte dhe evidenca, që administrohen në IAL dhe më pas shërbejnë për hartimin e raportimeve periodike të institucionit. NjZhKC bën vlerësime të programit të studimit dhe publikon rezultatet e vlerësimit nëpërmjet një raporti vjetor (<i>Evidenca 1. 06 Raporti vjetor i monitorimit dhe sigurimit të cilësisë</i>). Dokumentacioni përdoret edhe për vlerësimet periodike nga institucioni në nivel departamenti, dekanati dhe rektorati, në

	procesin e hartimin të raporteve si dhe gjatë procesit të akreditimeve institucionale dhe programore.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Të gjitha rezultatet e monitorimit të cilësisë së programit të studimit përfshihen në Raportin Vjetor të Vlerësimit të Cilësisë dhe Raportin e Vlerësimit të Studentëve. Raporti vjetor i institucionit analizon shkallën e realizimit të veprimtarive të njësive përbërëse të UniBa, si dhe përcakton objektivat dhe rekomandimet përkatëse. Format dhe përmbajtje të ngjashme kanë edhe në raportet mbi veprimtarinë e njësive kryesore apo atyre bazë. Në raportet e saj, NjZhKC pasqyron rezultatet që vijnë nga vlerësimi i treguesve të cilësisë, përpunimi i anketimeve si dhe arritjet dhe mangësitë e konstatuara. Pjesë e këtyre raporteve janë edhe analizat dhe konkluzionet mbi çështjet e evidentura nga procesi i vlerësimit të cilësisë, si dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. Raporti shqyrtohet nga organet vendimmarrëse të institucionit dhe vërejtjet dhe sugjerimet kthehen në masa konkrete. <i>(Evidenca 1. 06 Raporti vjetor i monitorimit dhe sigurimit të cilësisë).</i> <i>(Evidenca 2.82 Raporti i Vlerësimit të Studentëve VA 2023-2024)</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo	GVJ ka konstatuar se IAL, në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së këtij programi studimi, përdor mekanizma të drejtpërdrejta të vlerësimit si: Vlerësimi i veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore nga Departamenti; Vlerësimi i aftësive dhe metodave të mësimdhënies nëpërmjet vëzhgimit në auditor; Vlerësimi i kurrikulës dhe mbarëvajtjes së programit të studimit, nëpërmjet <i>Raportimit për punën semestrale (Format i raportimit të punës semestrale)</i>; Vlerësimi i rezultateve të studentëve gjatë vitit, nëpërmjet <i>Regjistrat të vlerësimit të vazhduar të studentëve të programit</i>; Këto metoda i referohen si vlerësimit të përmbajtjes së programit të studimit, ashtu edhe vlerësimit të komponentëve të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodatat e drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë janë objekt rregullimi në aktet e brendshme rregullatore si Manuali i Cilësisë, Rregullorja e Programit të Studimit, Rregullorja e Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës dhe rregulloret në nivel departamenti.

Konur

[Signature]

kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	(Evidenca 2.75 Manuali i Cilësisë); (Evidenca 2.81 Rregullore e Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës); (Evidenca 2.15 Format i raportimit të punës semestrale); (Evidenca 2.53 Regjister i vlerësimit të vazhduar të studenteve të programit);			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ ka konstatuar se IAL për të vlerësuar performancën e programit të studimit, aplikon edhe metoda indirekte si: Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga pedagogët, nëpërmjet <i>Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë (peer evaluation of teaching)</i>; Vlerësimi i komponentëve të komponentëve të mësimdhënies dhe mësimnxënies nga vetë studentët, nëpërmjet <i>Anketimit të studentëve në fund të çdo semestri</i>; Rezultatet e diskutimeve të Qeverisë studentore (https://umb.edu.al/news5488.html); Në këtë kuadër, si instrument i tërthortë i vlerësimit të performancës së programit, shërbejnë dhe pyetësorët e studentëve Alumni, të cilët realizohen nga Zyra e Alumnit dhe Karrierës, nëpërmjet të cilëve kryhen studime periodike për nivelin e punësimit të studentëve. (Evidenca 2.82 Raporti vjetor i vlerësimit të studentëve VA 2023-2024); (Evidenca 2.79 Formular vlerësimi të mësimdhënies kolege me kolege); (Evidenca 1.18 Plani strategjik 202-2025 Zyra Alumni dhe Karriera.			
Konkluzione	IAL përdor, përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike, metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për të monitoruar dhe vlerësuar programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Prokuror

[Signature]

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar tek Strategjia e Zhvillimit Institucional, Institucioni syjon “Kërkimin Shkencor, Aplikativ”, duke garantuar se <i>kërkimi shkencor në UniBa orientohet drejt aplikimeve në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit e më gjerë, duke synuar zhvillimin e inovacioneve dhe rritjen dhe aftësimin e vazhdueshëm të kapitalit njerëzor, shtimit e fuqizimit të mundësive e kualiteteve të ekspertizës; duke adaptuar një veprimtari të gjerë korporative, me mjaft partnerë cilësorë, në këtë drejtim ai zhvillon open innovation në lidhjet e tij të ngushta me bizneset dhe industrinë.</i> Gjithashtu IAL ka theksuar “Ndërveprimin me Industrinë”, duke garantuar që <i>institucioni të ndryshojë natyrën e marrëveshjeve me botën e industrisë e biznesit, duke vënë theksin në përcaktimin e nevojës së hartimit të programeve konkrete të realizimeve të këtyre punimeve brenda detyrave të zhvillimit të procesit kërkimit dhe atij mësimor. Evidenca 1.03 Plani strategjik i zhvillimit 2020-2023).</i> Megjithatë, pavarësisht miratimit të politikave në aktet kryesore rregullatore, nuk u konstatuan raste konkrete eventesh, apo takimesh, ku IAL të ketë marrë mendimin e përfaqësuesve të bizneseve për zhvillimin dhe përshtatjen e programeve të studimit, për të siguruar që ato të jenë në përputhje me nevojat e tregut. <i>Rekomandohet që të organizohen takime, apo dhe më tej mund të themelohen borde/komisione me pjesëmarrjen e aktorëve të tregut, ku të kërkohet dhe të merret mendimi i përfaqësuesve të biznesit.</i> Pjesëmarrja e stafit akademik (kategorisë “profesor” dhe “lektor”) si dhe një përfaqësuesi të studentëve, në strukturat që monitorjnë dhe garantojnë cilësinë (psh. në Komisionin e Sigurimit të Standarteve dhe Cilësisë (KSSC) është parashikuar në aktet rregullatore të IAL-së <i>(Evidenca 1.08 Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Cilësië).</i> Gjithashtu, këto akte rregullatore parashikojnë pjesëmarrjen e studentëve edhe në organet vendimmarrëse të institucionit, si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm të çdo programi studimi. <i>(Evidenca 1.01 Statuti i Universitetit). (Evidenca 1.02 Rregullore e UniBa).</i>

Kronica

Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	IAL ka hartuar një bazë të gjerë rregullatore, nëpërmjet të cilës ka ngritur dhe bërë funksional sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në zbatim të këtij sistemi, aktet rregullatore kanë përcaktuar strukturat përgjegjëse si dhe detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për secilën prej tyre. Kompetencat dhe detyrat e e strukturave kryesore të vlerësimit të cilësisë specifikohen në Rregulloren e IAL-s, Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, si dhe në planin e punës së Nj.Zh.K.C. Në dokumentin “Mnuali i cilësisë” (Evidenca 2.75) gjenden gjithashtu të përshkruara detyrat dhe përgjegjësitë e autoriteteve apo organeve, që bëjnë pjesë në sistemin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, si psh të Senatit; Rektori; Drejtuesi i njësisë kryesore; Nj.Zh.K.C dhe grupet e vlerësimit të brendshëm. <i>(Evidenca 1.02 Rregullore e IAL-s)</i> <i>(Evidenca 1.08 Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë)</i> <i>(Evidenca 1.07 Rregullore e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë)</i> <i>(Evidenca 2.80 Plani i punës së Nj.Zh.K.C)</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Nëpërmjet akteve të brendshme rregullatore IAL ka përcaktuar kompetencat, detyrat dhe rolin e strukturave të brendshme dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Në këtë mënyrë IAL garanton përfshirjen e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit ndihmës akademik e administrativ dhe studentëve të programit të studimit në këtë proces. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë (DD), njësia bazë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD). Referuar rregullores së IAL-së, Rregullorës së Departamentit, Rregullorës së Programit të Studimit, Rregullores së Nj.Zh.K.C, Departamenti i Drejtësisë mbikqyr veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe administrative që lidhet me këtë program studimi. Anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm. për programin e studimit janë: pedagogë pjesë e njësisë bazë që ofron programin; personel administrativ dhe studentë të programit (Urdhëri nr.59, datë 18.12.2024 i Rektorit të UniBa).

Komisi

[Signature]

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Proceset e vlerësimit të brendshëm janë periodike dhe ciklike. Në përbërje të grupeve të vlerësimit të brendshëm përfshihen dhe akvizohen personel të IAL-së dhe studentë, duke respektuar integritetin akademik të stafit akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve. Të njëjtat parime të respektimit të integritetit akademik dhe mosdiskriminimit janë sanksionuar dhe në aktet kryesore rregullatore të IAL-së (Statut dhe Rregullore). Kështu, në Statutin e IAL-s, neni 3/3 parashikohet se <i>“Veprimtaria e IAL me studentët dhe personelin mbështetet në meritat personale dhe përjashton çdo lloj diskriminimi”</i>. Politikat si dhe strategjitë zhvillimore të institucionit udhëhiqen nga respektimi i parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit në zbatimin të procedurave të mbikqyrjes dhe vlerësimit të cilësisë. Këto parime udhëheqin gjithashtu veprimtarinë akademike, kërkimore dhe shkencore të personelit akademik. Departamenti i Drejtësisë, pranë të cilit ofrohet dhe ky program studimi, respekton lirinë akademike të stafit akademik, në procesin e hartimit të përmbajtjes së syllabuseve dhe programeve të lëndëve si dhe veprimtaritë e ndryshme akademike. <i>(Evidenca 1.01 Statuti i IAL-së).</i> <i>(Evidenca 1.10 Kodi i Etikës).</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të jenë edhe bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm, apo dhe përfaqësues të institucioneve partnere. Një politikë e tillë rezulton e pranuar në aktet që përvijojnë strategjinë e veprimtimit të IAL-së, por e pazbatuar në fakt. Nga Departamenti i Drejtësisë janë organizuar tryeza të rumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve etj. ku janë ftuar ekspertë të fushave të ndryshme <i>(Evidenca 2.35)</i>. Por në këto akvite nuk rezulton të jetë diskutuar mbi performancën apo cilësinë e programit të studimit PIND “MSH në Drejtësi”. Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional IAL ka theksuar nevojën për “Ndërveprimin me Industrinë”, duke vënë theksin në përcaktimin e nevojës së hartimit të programeve konkrete që i përshtaten tregut të punës. Gjithashtu, në kuadrin strategjik,

	UniBa synon "Kërkimin Shkencor, Aplikativ". (Evidenca 1.03- Plani strategjik i zhvillimit 2020-2023). Megjithatë, pavarësisht miratimit të politikave në aktet kryesore rregullatore, nuk u konstatuan raste konkrete eventesh, apo takimesh, ku IAL të ketë marrë mendimin e përfaqësuesve të bizneseve, apo të institucioneve të tjera, apo të ekspertëve të jashtëm, për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit. <u>Rekomandohet që të organizohen takime me ekspertë apo me përfaqësues të institucioneve partnere, për të diskutuar mbi cilësinë dhe performancën e programit të studimit PIND "MSH në Drejtësi". Mund të themelohen edhe borde apo komisione me pjesëmarrjen e aktorëve të tregut, ku të kërkohet dhe të merret mendimi i ekspertëve apo përfaqësuesve të biznesit. Në grupin e GVB mund të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm.</u>			
Konkluzione	GVJ ka konstatuar se IAL përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Nuk u konstatuan raste konkrete ku IAL të ketë marrë mendimin e përfaqësuesve të bizneseve, apo të institucioneve të tjera, apo të ekspertëve të jashtëm, për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit. Rekomandohet që të organizohen takime me ekspertë apo me përfaqësues të institucioneve partnere, për të diskutuar mbi cilësinë dhe performancën e programit të studimit PIND "MSH në Drejtësi". Mund të themelohen edhe borde apo komisione me pjesëmarrjen e aktorëve të tregut, ku të kërkohet dhe të merret mendimi i ekspertëve apo përfaqësuesve të biznesit. Në grupin e GVB mund të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Konkluzi

[Signature]

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Referuar akteve të brendshme rregullatore, rezulton se UNIBA ka miratuar politika dhe strategji të qarta për sigurimin e cilësisë. Gjithashtu këto akte krijojnë struktura të posaçme të dedikuara për sigurimin e cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë, të miratuara me aktet rregullatore, janë transparente dhe publikohen në faqen e dedikuar të institucionit për Sigurimin e Cilësisë. https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html Po kështu aktivitetet e realizuara në kuadër të sigurimit të cilesisë bëhen transparente: https://umb.edu.al/news4901.html https://umb.edu.al/news5030.html
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në IAL ndërtohet mbi parime të përcaktuara në Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NjZhKC), të cilat mbahen parasysh në aktivitetet që kanë lidhje me vlerësimin e cilësisë së programit të studimit PICD "MSH në Drejtësi" (<i>Evidenca 1.07 Rregullore e Nj.Zh.K.C</i>). Transparenca sigurohet nëpërmjet publikimit të raportit vjetor të NjZhKC, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Ndonëse raportet vjetore të NJSBC shapallen publikisht, publikimi i referohet konkluzioneve dhe rekomandimeve të natyrës së përgjithshme që i referohen treguesve të cilësisë. Rezultatet e sondazheve dhe vlerësimit të studentëve për secilin nga pedagogët transmetohen në rrugë zyrtare. (<i>Evidenca 1.06 Raport vjetor i monitorimit dhe Sigurimit të cilësisë VA 2023-2024</i>)
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Referuar Rregullores së Nj.Zh.K.C, vlerësimi i brendshëm i cilësisë në UniBa, i nënshtrohet, ndër të tjera, edhe këtyre kritereve: - Vlerësimi kryhet duke zbatuar parimin e autonomisë institucionale. - UniBa e përdor vlerësimin për të: (i) përcaktuar nivelin e cilësisë së arritur; (ii) evidentuar praktikat pozitive; (iii) sjellë përmirësime, ndryshime dhe zhvillime pozitive; (iv) marrë vendime.

Handwritten signature

Handwritten signature

	<i>-Vlerësimi kryhet në çdo aspekt të veprimtarisë institucionale, mësimore, kërkimore, e administrative.</i> <i>-Vlerësimi mbështetet në një shumëllojshmëri burimesh.</i> GVJ ka konstatuar se në raportin vjetor, NjZhKC identifikon: • Pikat e forta dhe të dobëta të njësive; • Jep rekomandime për përmirësim që shqyrtohen nga organet drejtuese të IAL; • Plani i masave i nxjerrë nga raporti ndihmon në shmangien e dobësive dhe ruajtjen e cilësisë së programeve të studimit; <i>(Evidenca 1.06 Raport vjetor i monitorimit dhe Sigurimit të cilësisë VA 2023-2024),</i> <i>(Evidenca 2.82 Raport i Vlerësimit të Studentëve VA 2023-2024).</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Raportet vjetore që hartohen nga strukturat kompetente të vlerësimit të cilësisë si dhe raportet e vlerësimit periodik të veprimtarive kanë pjesë të formatit të tyre edhe konkluzionet që evidentohen nga analiza e treguesve të cilësisë. Raporti vjetor i Nj.Zh.K.C përmban gjithashtu konkluzionet dhe rekomandimet për marrjen e masave për korrigjimin e mangësive. Ky raport përmban edhe analizën SËOT, pjesë e të cilës janë pikat e forta, pikat e dobta dhe rekomandimet që evidentohen nga pyetësorët dhe instrumentat e tjerë të cilësisë. Këto raporte u bëhen të njohura strukturave përkatëse drejtuese dhe më tej, shërbejnë për hartimin e planeve të masave me qëllim përmirësimin e komponentëve të cilësisë. GVJ ka konstatuar nëpërmjet evidencave dhe gjatë vizitës në IAL se përmirësimi i programeve ndodh nëpërmjet: • Pasurimit të literaturës dhe temave mësimore • Ndryshimeve profilizuese të lejuara deri në 20% në përputhje me legjislacionin <i>(Evidenca 1.06 Raport vjetor i monitorimit dhe Sigurimit të cilësisë VA 2023-2024), (Evidenca 2.82 Raport i Vlerësimit të Studentëve VA 2023-2024).</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari	Konkluzionet që evidentohen nga raportet vjetore të Nj.Zh.K.C diskutohen me stafin akademik, por IAL informon edhe studentët

Handwritten signature

Handwritten signature

periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	mbi politikat e vlerësimit të cilësisë dhe rezultatet e raporteve vjetore. Publikimi i konkluzioneve të raporteve vjetore, në faqen zyrtare të planeve strategjike si dhe raporteve të NJSBC i shërben jo vetëm transparencës, por edhe informimit në një shkallë të gjerë të personelit akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ mbi veprimtaritë e ndërmara në kuadrin e vlerësimit të cilësisë, dhe masat e nevojshme për përmirësimin e cilësisë. Njohja me këto raporte rrit ndërgjegjësimin mbi përgjegjësitë dhe rolin e personelit akademik dhe studentëve në përmirësimin e treguesve të cilësisë. Referencat gjenden në adresat: https://umb.edu.al/news4901.html https://umb.edu.al/news5125.html https://umb.edu.al/news5030.html			
Konkluzione	<i>Në IAL, politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit PICD "MSH në Drejtësi" janë publike, transparente dhe efektive. Institucioni siguron efektivitetin e këtyre veprimtarive në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. IAL organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Komiteti

[Signature]

Përfundime të Vlerësimit të programit të Integruar i Nivelit të Dytë "Master i Shkencave në Drejtësi" ofruar nga Universiteti "Barleti"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Cilësia e personelit akademik dhe eksperiencat e tyre të pasura jo vetëm teorike, por edhe praktike, që garantojnë cilësi të lartë në mësimdhënie dhe aktivitetet akademike;
2. Njësia bazë (Departamenti i Drejtësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë) ka ndërtuar një klimë bashkëpunimi, e cila ka ndikuar pozitivisht në lirinë akademike, në performancën e stafit të saj dhe në marrëdhëniet me studentët;
3. Infrastruktura e IAL dhe mbështetja logjistike dhe financiare e siguruar nga drejtuesit dhe financuesit, që ka siguruar ecuri të qëndrueshme të programit;
4. Laboratorët dhe infrastruktura e teknologjisë së informacionit të disponueshme për studentët dhe për zhvillimin e tyre të karrierës;
5. Ndihma dhe mbështetja që studentët e programit marrin në IAL, që fillon që nga hyrja e tyre në institucion deri në përfundim të studimeve dhe që përmirëson orientimin e tyre në tregun e punës;

b. Pika të dobta:

1. Angazhimi në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi edhe të stafit akademik me Msc, ndërkohë që kërkohet që stafi akademik të ketë të paktën gradë shkencore (Dr), sipas parashikimit të nenit 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet niveli i kualifikimit akademik; *(Standarti IV.1, Kriteri 1)*
2. Numri i vogël i marrëveshjeve me institucione shtetërore (institucione të administratës shtetërore, apo institucione të pavarura), për të garantuar një marrëdhënie të qëndrueshme për realizimin e objektivave e procesit mësimor dhe praktikave mësimore të studentëve *(Standarti I.3, Kriteri 2)*
3. Mungesa e Klinikës së Ligjit, strukturë që ndikon në rritjen e aftësive praktike të studentëve dhe që konsiderohet një praktikë bashkëkohore në përmirësimin e të nxëniet në programin e studimit PICD "Master i Shkencave në Drejtësi"; *(Standarti I.3, Kriteri 3)*

Armeni

Ally

Rekomandime

1. Departamenti të rrisë më tej nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të zgjerojë pjesëmarrjen në programin Erasmus+ dhe projekte të ngjashme, në drejtim të mobilitetit të stafit akademik dhe veçanërisht të studentëve;
2. Institucioni të marrë masa për angazhimin në procesin e mësimdhënies, në këtë program studimi, vetëm staf akademik që të ketë të paktën gradë shkencore (Dr), sipas parashikimit të dispozitave ligjore në fuqi;
3. Të ngrihet dhe të vihet në funksion Klinika e Ligjit pranë Departamentit të Drejtësisë. Kjo formë bashkëkohore e të mësuarit praktik është e domosdoshme për programet e studimit në fushën e drejtësisë, pasi ndihmon studentët të përfshihen në mënyrë aktive në trajtimin e çështjeve konkrete ligjore, duke ndërlidhur teorinë me praktikën dhe duke i përgatitur ata në mënyrë më të plotë për tregun e punës;
4. Të ndërmerren veprime konkrete efektive promovuese kundrejt stafit akademik për arritjet më të mira në programin e studimit siç mund të jetë mbështetja financiare apo mbulim i shpenzimeve për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kërkimore;
5. Të angazhohen më shumë studentë për të marrë pjesë në konferenca e publikime shkencore, duke ofruar IAL-ja dhe mjetet e duhura të incentivimit të kësaj pjesëmarrje nëpërmjet edhe mbështetjes financiare;
6. Të rritet numri i marrëveshjeve që IAL-ja ka me institucionet shtetërore (institucione të administratës shtetërore, apo institucione të pavarura), për të garantuar një marrëdhënie të qëndrueshme për realizimin e praktikave mësimore edhe të studentëve të programit të studimit PIND "Master i Shkencave në Drejtësi";
7. Në përfundim të raportimeve përmbledhëse të anketimeve për IAL-në, të hartohen Raporte të detajuara për Departamentin e së Drejtës, që të përmbajnë konkluzionin e opinionit të studenteve specifikisht për lëndët e programit të studimit PIND "MSH në Drejtësi", ku mundësisht të evidentohen dhe rekomandimet e titullarëve për masat që duhen marrë për të përmirësuar eventualisht elementë specifikë të procesit mësimor;
8. Të organizohen takime me ekspertë apo me përfaqësues të institucioneve partnere, për të diskutuar mbi cilësinë dhe performancën e programit të studimit PIND "MSH në Drejtësi". Mund të krijohen borde apo komisione të përbashkëta të stafit akademik dhe drejtues të IAL-së me pjesëmarrjen e aktorëve të tregut, ku të merret mendimi i përfaqësuesve të biznesit, për zhvillimin dhe rritjen e cilësisë dhe përshtatjen e programeve të studimit në përputhje me nevojat e tregut;
9. Të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të rritur të ardhurat dytësore, që mund të vijnë nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nga shërbimet ndaj të tretëve;
10. Universiteti të miratojë kuota pranimi për kategori të veçanta studentësh, përfshirë kandidatë me aftësi të veçanta, pakica dhe shtresa të marginalizuara, si dhe kandidatë nga shtete të tjera, në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore përkatëse;

Pranica

Evaluation's conclusions for the Integrated Second Level study program "Master of Sciences in Law" provided by the Higher Education Institution "Barleti University"

a. Strengths and affirmations:

1. The academic staff are highly qualified and bring a wealth of both theoretical knowledge and practical experience, ensuring high-quality teaching and academic activities;
2. The core unit (Department of Law, Faculty of Economy, Governance and Law) has fostered a cooperative environment that supports academic freedom, enhances staff performance, and strengthens relationships with students;
3. The institution's infrastructure, along with the logistical and financial support provided by its leadership and funding bodies, has contributed to the program's sustainable development;
4. Students benefit from access to well-equipped laboratories and advanced information technology resources, which support their academic success and career development;
5. Comprehensive support services are offered to students from the moment they enter the institution until graduation, significantly improving their preparation for the labor market;

b. Weaknesses:

1. The involvement of academic staff holding only an MSc degree in the teaching process of this study program, despite the legal requirement that academic staff must hold at least a doctoral degree (PhD), as stipulated in Article 59/6 of Law No. 80/2015, which defines the minimum academic qualification level; (*Standard IV.1, Criterion 1*)
2. The limited number of agreements with state institutions (including public administration and independent bodies), which are essential for establishing stable partnerships to support the objectives of the learning process and to facilitate student internships and practical training; (*Standard I.3, Criterion 2*)
3. The absence of a 'Law Clinic', a key structure that enhances students' practical skills and is widely recognized as a modern and effective educational tool, particularly in the "Master of Science in Law" study program; (*Standard I.3, Criterion 3*)

Recommendations

1. The Department should further enhance international cooperation and expand participation in Erasmus+ and similar programs, focusing on both academic staff and, especially, student mobility;
2. The HEI must involve in this program only academic staff holding at least a doctoral degree (PhD), as stipulated by Albanian legal framework;
3. The Department of Law should establish the 'Law Clinic'. This modern form of experiential learning is essential for legal education, enabling students to engage with real legal cases, integrate theoretical knowledge with practical experience, and better prepare for the labor market;
4. Concrete and effective promotional measures should be taken to recognize and support academic staff for their achievements within the study program. This may include financial incentives or covering expenses for participation in conferences and research activities;
5. Student participation in academic conferences and scientific publications should be encouraged by the Institution through appropriate incentives, including financial support, to foster research engagement;
6. The Institution should increase the number of formal agreements with state institutions (including public administration and independent bodies) to establish stable partnerships that support teaching practices for students enrolled in the Integrated Second Level Program "Master of Science in Law";
7. In addition to the overall summary of survey results at the Institution level, detailed reports should be prepared specifically for the Department of Law. These reports should include student feedback on the Integrated Second Level Program "Master of Science in Law" and clearly identify departmental recommendations for potential improvements to specific elements of the learning process;
8. Meetings should be organized with experts and representatives of partner institutions to assess the quality and performance of the Integrated Second Level Program "Master of Science in Law". Joint committees or advisory boards comprising academic, administrative, and industry representatives should be established to ensure the program's continuous development and alignment with labor market demands;
9. Ongoing efforts should be made to increase the Institution's secondary income through national and international projects, as well as by offering services to third parties;
10. The University should adopt admission quotas for specific student categories, including individuals with special abilities, minorities, marginalized groups, and international applicants, in accordance with applicable regulations and by-laws;

konusi



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Bonus

[Signature]